

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

13.02.2025

Ora 15:26

**RENDI I DITËS**

*Projektvendim “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”.*

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Znj. M. Çelmeta, znj. J. Josifi,  
znj. P. Doçaj, znj. A. Agolli**

**Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (znj. E.Xhina)**

**OJQ: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretarja e Përgjithshme dhe zyrtarë të tjerë të administratës së KQZ-së, përfaqësues të partive politike, përfaqësues të shoqërisë civile. Në mbledhjen e ditës së sotme kemi në rendin e ditës një projektvendim për “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”. Ndërkohë kemi dhe një projektvendim të mbartur nga mbledhja e kaluar, projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Çështje jashtë rendit të ditës kemi kolegë? Përfaqësuesit e partive? Zoti Nuri?

*Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po.*

*Znj. I. Nano: Në fund të shqyrtimit të akteve.*

*Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit!*

*Znj. I. Nano: Zonja Xhina?*

*Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Po, gjithashtu.*

*Znj. I. Nano: Faleminderit! Me radhë, zoti Nuri, zonja Xhina. Atëherë, fillojmë me projektvendimin që kemi në rendin e ditës “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”. Bëhet fjalë për vendimin me të cilin kemi miratuar listën e dokumentacionit, që u kërkohet shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit për t’u regjistruar në*

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

platformën elektronike të regjistrimit. Zonja Josifi do t'ju lutesha shkurtimisht, ku konsistojnë këto ndryshime dhe nga ka lindur nevoja që diktoi këto ndryshime.

**Znj. J. Josifi:** Faleminderit! Në mbështetje të nenit 20, pika 1, shkronja “dh”, të Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet kompetenca e Komisionit Rregullator për të shqyrtuar dhe miratuar projektaktet me karakter normativ, të përgatitura nga administrata e KQZ-së ose nga anëtarët e tij, për rregullat për regjistrimin e votuesve nga jashtë vendit, procedurat e votimit, administrimit dhe numërimit të votave nga jashtë vendit si dhe përfshirjen e tyre në rezultatin e përgjithshëm të zgjedhjeve për Kuvend. Gjithashtu në zbatim të nenit 25, pika 5 ku përcaktohet, se zgjedhësi që dëshiron të votojë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pas hapjes së procesit të regjistrimit aplikon në mënyrë individuale për regjistrimin në listën e zgjedhësve përmes platformës elektronike për regjistrimin e këtyre kërkesave, krijuar, mirëmbajtur dhe përditësuar nga KQZ-ja dhe lista e detajuar e dokumentacionit që kërkohet për regjistrim përcaktohet me vendim të Rregullatorit. Në këtë rast vendimi juaj me nr. 11, i datës 1 nëntor 2024. Siç e dini procesi i regjistrimit të votuesve nga jashtë për zgjedhjet për Kuvend, të datës 11 maj 2025, ka filluar e ka vijuar me intensitet të lartë. Për të adresuar sfidat aktuale dhe me qëllimin që të përmirësojmë, por edhe ta lehtësojmë procesin e regjistrimit për zgjedhësit nga jashtë vendit, e kemi parë të arsyeshme të bëhen në këtë vendim disa shtesa edhe ndryshime. Qëllimi është që zgjedhësi të ketë më shumë hapësirë në drejtim të dokumentacionit që ai ngarkon në platformën elektronike të regjistrimit, për të provuar adresën që dëshiron t'i shkojë zarfi me fletën e votimit. Për këtë arsye pas pikës 1 të kreut II, të këtij vendimi, kemi propozuar të shtohet pika 2 me këtë përmbajtje: “Dokumenti i cili e vërteton qëndrimin e zgjedhësit nga jashtë territorit mund të ngarkohet në PER dhe nga çdo anëtar i familjes së personit në emër të të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

cilit është ky dokument”. Në këtë rast do të duhet të ngarkohet si provë lidhjes një nga katër dokumentat e listuara në këtë projektvendim: një certifikatë familjare ose një certifikatë personale e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti, apo një nga dokumentat shqiptarë të identitetit të personit në emër të të cilit është dokumenti apo një deklaratë e lëshuar nga personi në emër të të cilit është dokumenti. Gjithashtu pas kësaj pike kemi propozuar të shtohet një pikë tjetër, në këtë kategori bëjmë fjalë për kur zgjedhësi do të përdorë si dokument provues të adresës, dokumentin provues të një personi i cili nuk është në rrethin e tij familjar. Pra, ndryshe nga pika 2 më lart, në këtë rast propozojmë që dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast do të duhet që personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës të lëshojë një deklaratë, pra e ngjashme me germën “d”, të pikës 2 më lart. Këto janë dy ndryshimet që ne propozojmë. Pika 2, e kreut II bëhet pika 4 për pasojë. Për sa më lart në këtë relacion, Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve brenda kompetencave të veta, në respektim të detyrimeve, afateve ligjore të përcaktuara në Kod, propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “Për disa ndryshime në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024, të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”. Ju faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Josifi! Fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë keni diçka në parim?

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

*Znj. H. Vukaj:* Në parim, në lidhje me propozimin e ardhur nga KSHZ. Më lejoni të shtoj edhe të përcjell pozitivitet për nismën e marrë, është një thirrje që është bërë për shumë herë në mbledhjet tona nga unë edhe nga kolegu Muharrem Çakaj. Nevoja për ta thjeshtuar procesin padyshim ka qenë edhe premisa dhe qëllimi i thirrjeve tona të herëpashershme, dëshpërimisht është krijuar perceptimi dhe konstatimi që kjo platformë mbetet një platformë e vështirë dhe për rrjedhojë jo gjithëpërfshirëse. Ndaj ky hap i sotshëm është për t'u përshëndetur sepse u krijon mundësinë të gjithë regjistruarve dhe aplikantëve për t'u regjistruar, që të kenë një lehtësi tjetër në përdorim të, ose në mbartje, ose provim të adresës së tyre të banimit me qëllim që t'i shkojë fleta e votimit, jo në adresën domosdoshmrisht në emrin e tyre por në një adresë e cila figuron në emër të familjarit të tyre apo të një bujtësi. Pra adresëmbajtësi, i cili s'ka lidhje gjaku me të dhe që do të provohet ose do të mbështetet përmes një deklaratë nga ana e adresëmbajtësit. Në vazhden e aplikimit ose të mënyrës sesi duket ky proces, më lejoni të shtoj edhe një moment analitik që unë i kam bërë këto ditë platformës dhe shifrave të saj. Me të drejtë më lind dilema dhe më lindin pikëpyetjet në fakt, sesi ka mundësi që po të shikojmë shifrat dhe t'i referohemi shifrave, vendi fqinj Greqia në raport me Italinë apo Gjermaninë ka një përqindje më të ngushtë refuzimesh dhe përqindje më të ngushtë të kërkesave, të cilat në raport me aplikimet janë të pranuar. Mos vallë atje është përqëndruar gjithë shtresa intelektuale? Në dijeninë tonë fasha emigratore intelektuale është drejt Gjermanisë. Pse kjo diferencë, mes Italisë dhe Greqisë? Kur ne kemi, pjesën dërrmuese të emigrantëve tanë, të cilët kanë të njëjtën platformë, kanë të njëjtat kushte përpara tyre, por me sa duket nuk kanë të njëjtit suportues dhe për fatin tonë të keq, i ka shërbyer në fakt edhe moszbatimit dhe aplikimi i vendimit 9, për veprimtaritë e ndaluara. Kjo analizë është dëshpëruese kur t'i mendon dhe sjell nëndërmend faktet e përcjella nga media këto kohë për të gjithë bashkitë e jugut të

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

Shqipërisë, të cilat kanë vërshuar në shtetin fqinj Greqi dhe kanë filluar tentativat edhe të përshfaqjen si anëtarë ose punonjës të KQZ-së dhe jo vetëm tentativa, por de facto, të demostuara dhe të faktuara nga mediat tashmë ose rastet, të cilat përfaqësuesi i Partisë Demokratike disa herë këtu në këtë sallë i ka proklamuar dhe i ka denoncuar, madje ka kërkuar që të merren masa nga KQZ. Në këtë kuadër unë do të doja të dija, nëse ju keni dijeni gjithmonë, sepse ju nuk përfaqësoni dot KQZ-në në këtë tryezë, pavarësisht se legjitimohet Sekretari i Përgjithshëm që të jetë, por ju nuk dini ndoshta të vërtetën, ndoshta dhe mund ta dini, a ka marrë KSHZ-ja ndonjë rol proaktiv në raport me punonjësen, pseudopunonjësen, e cila mori kreditet e KQZ-së dhe i përdori në një ambient kolektiv, masiv, ku nxiteshin përmes këtyre krediteve aplikuesit dhe shtetasit shqiptarë me banim në Greqi që ta besonin dhe të regjistroheshin në platformë PER? A dini ju që KSHZ të ketë marrë ndonjë masë aktive përtej asaj administrative ose të ketë nisur ndonjë hetim ose kallëzim, për të vënë të paktën dinjitetin e KQZ-së në vend dhe për të mos lejuar raste të tjera abuzive, të cilat deri para pak, përfaqësuesi i Partisë Demokratike, i proklamoi si problematike dhe fenomen? A keni dijeni se ç'ka ndodhur me KSHZ-në përveç deklaratës së tij në media, që distancohej, por në fakt unë e lexoj si mbrojtje të këtyre personave abuzues apo spekulues me emrin e KQZ-së.

**Znj. I. Nano:** Zonja Doçaj, po!

**Znj. P. Doçaj:** Nëse mundem? Duke qenë se dhe platforma e denoncimeve administrohet nga Drejtoria Ligjore, ne kemi administruar disa kërkesa, ankesa apo ankime nga përfaqësuesi i Partisë Demokratike, kemi marrë vendim për fillimin e procedurës administrative dhe po bëjmë hetim administrativ në lidhje me këto

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

denoncime. Jemi në fazën e hetimit administrativ, ndoshta më pas do të procedojmë edhe me veprime të tjera, nëse do të jetë rasti. Aktualisht, procedurialisht...

**Znj. H. Vukaj:** Realisht zonja ishte punonjëse e KQZ-së apo jo?

**Znj. P. Doçaj:** ...jemi në proces. Jo, nga hetimi nuk rezulton, por gjithsesi në fazën në hetim procedural, jemi në këtë pikë.

**Znj. H. Vukaj:** Edhe pas marrëveshjes që KSHZ-ja lidhi me Prokurorin e Përgjithshëm nuk ka një rol më të avancuar në raport me ndërprerjen e këtij fenomeni dhe mosndikimin e tij në pabarazinë në zgjedhje dhe implikimin kaq rëndë të pseudoadministratës?


**Znj. P. Doçaj:** Gjatë hetimit administrativ do të na dalin prova të reja, kështu që...

**Znj. H. Vukaj:** E kuptova, pra nuk ka asnjë rol aktiv në drejtim të parandalimit të këtij fenomeni sepse çdo vonesë shkon në favor, ne po i afrohem zgjedhjeve tashmë, po i afrohem proceseve të përfundimit të regjistrimit e kështu me radhë, kështu ç'efekt ka në 2026 apo 2027. Faleminderit zonja Nano!

**Znj. I. Nano:** Donte, në mos gaboj, zonja Josifi të shtonte diçka për këtë çështje dhe pastaj zoti Çakaj diskutimin në parim të projektaktit? Po. Faleminderit! Zonja Josifi!

**Znj. J. Josifi:** Ndërkohë për rastin në fjalë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka mbajtur një deklaratë publike në datën 9 shkurt, ku sqarë se KQZ-ja nuk ofron regjistrim në terren, nuk ka autorizuar asnjë person tjetër që në emër dhe për llogari

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

të institucionit të angazhohet në procesin e regjistrimit të votuesve nga jashtë dhe kushdo që konstaton persona që prezantohen si përfaqësues të KQZ-së në ambiente të tjera, jashtë institucionit duhet ta denoncojnë menjëherë rastin, pranë organit të Prokurorisë. Përtej kësaj, KQZ-ja siguron të gjithë votuesit nga jashtë se procesi i regjistrimit është në përputhje me të gjithë standardet e sigurisë të vendeve të Bashkimit Europian, i mbrojtur nga çdo interes, ndikim politik apo partiak. KQZ dhe njëherë nuk ka autorizuar askënd tjetër, që në emër dhe për llogari të institucionit të angazhohet në procesin e regjistrimit të votuesve nga jashtë, as përbrenda vendit, më shumë akoma, as përjashtë vendit. Pra ka pasur një qendrim publik.

**Znj. H. Vukaj:** Po këtë unë e përmenda vetë zonja Josifi edhe fakti i bërë botërisht nuk “e shlyen dot”, në thonjëza kjo, peshën e Komisionerit për cënimin e emrit të KQZ-së edhe të këtij fenomeni, pra ai si rregull duhet të kishte nisur ai kallëzimin, procedimin për këtë zonjë, e cila ka abuzuar me këtë proces dhe me KQZ-në.

**Znj. I. Nano:** Zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Atëherë, së pari në lidhje me aktin e propozuar në fjalë dhe unë bie dakord që është një projektpropozim për t’u përshëndetur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Megjithatë unë risjell në vëmendje meqë është Drejtoresha e Votimit nga Jashtë, zonja Josifi, sjell në vëmendje dhe të administratës së KQZ-së, nisur nga numri i shumë i lartë i refuzimeve, pra zgjedhësve unik të refuzuar në këtë moment rezultojnë 32 845, ndërsa zgjedhës total të refuzuar rezultojnë, pra aplikime të refuzuara janë në total 70 378, që do të thotë nga 70 378, unik janë 32 845, pra diferenca gati 38 mijë e disa aplikime janë për të dytën, të tretën, të katërtën, të pestën herë. Në të gjitha rastet që ne kemi pasur në rend dite,

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*





*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

shqyrtimin e projektakteve për votimin nga jashtë përfshirë dhe propozimin për shtesa e ndryshime në vendimin nr. 11, ka qenë një kërkesë e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator, po edhe kolegë të tjerë kemi diskutuar lidhur me mundësinë e ndërveprimit, a të PER-it, a mundet apo jo? Nëse ju e gjykoni me vend mund të bëjmë propozime, së pari dhe së dyti në lidhje me numrin shumë të madh të kërkesave, pra këto 38 mijë që mund të jenë aplikime për herë të dytë, të tretë, të katërt, ndoshta kemi dëgjuar dhe për herë të 45. A funksion linja e komunikimit? Po, unë e kam dëgjuar personalisht, ka aplikantë që kanë aplikuar mbi 40 herë dhe përsëri është refuzuar, tani në këto raste që konstaton Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në rastin konkret drejtorja juaj e ngarkuar me këtë detyrë, ka komunikime ndërmjet KQZ-së dhe aplikantit të cilit i është refuzuar? Në gjykimin tim objektiv nëse refuzohet një kërkesë më shumë se dy apo tre herë atëherë ka diçka që nuk shkon me aplikimin. A merret në telefon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ky zgjedhës? Komunikohet, vihet komunikimi me këtë? Se PER-i nuk ndërvepron, pra kërkesat tona të vendimit nr. 10, me keqardhje konstatoj as nga KSHZ, as nga administrata nuk janë materializuar. Në rastin konkret, cila është procedura, e cila ndiqet nga KQZ për aplikimet e shumëfishta të refuzuara?

**Znj. J. Josifi:** Po i marr me radhë pyetjet tuaja. Aktualisht rezulton që 20% e zgjedhësve të cilët kanë aplikuar për t'u regjistruar janë të refuzuar, pra raporti 32 845 zgjedhës të refuzuar, me zgjedhës unikë, të cilët kanë bërë kërkesë për regjistrim është 20%. Ndërkohë sa i takon refuzimit edhe rastit që ju sollët, se ka pasur raste që 45 herë një zgjedhës ka bërë kërkesë dhe është refuzuar nuk qëndron. Në fakt ne kemi një raportin e njërit prej auditëve teknikienë, i cili ka bërë këtë analizë rasti më i shumtë në numër nga një zgjedhës që ka konstatuar ka qenë në fakt 22 kërkesa nga një zgjedhës. Ky është një rast, pra nuk është masiv. Ne e verifikuam këtë gjë dhe

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

pamë çfarë gabimi ishte bërë herë pas herë, në 21 herët kur ai zgjedhës ishte refuzuar, për të mos ndarë këtu të dhënat personale të zgjedhësit, rezultonte se ai banonte Belgjikë dhe 21 herë kishte dorëzuar si provë, si dokument provues të adresës ose patentën belge, e cila nuk e ka fare adresën ose dokumentin e identifikimit nga ana e përparme, e cila sërish nuk e ka adresën.

**Z. M. Çakaj:** Dakord, e kuptoj. Ky rasti specifik, këto të dhëna janë përftuar nga auditimi apo nga komunikimi që keni pasur me këtë zgjedhës?

**Znj. J. Josifi:** Atëherë rasti i kërkesës së shumtë, të këtij zgjedhësi u vu në dukje nga audituesi dhe ne hetuam rastin për të parë nëse vërtet kishim qenë korrektë në shqyrtimin e kërkesave të shumta të këtij zgjedhësi, rezultoi që në herën e 22, kur ai 21 herët e para kuptohet që kërkesat e tij ishin shqyrtuar nga operatorë të ndryshëm tanët, kujt i kishte rënë rastësisht ajo kërkesë për trajtim. Të gjithë kishin mbajtur të njëjtin qëndrim dhe në herën e 22, po i njëjti zgjedhës kishte ngarkuar pastaj një faturë të utilitetit, kishte emrin, mbiemrin e tij, kishte dhe të dhënat e plota të adresës. Nga hera e fundit që është bërë ky diskutim në mbledhje të Komisionit Rregullator, pra çështja e ndërveprimit zgjedhësit dhe mundësia që ne t'i qasemi atyre sa më shumë që mundemi, sidomos atyre që janë refuzuar, ne kemi shtuar dy forma komunikimi në linjat tona të ndihmës kemi shtuar mesazhet në facebook, messenger dhe për rastet e zgjedhësve të refuzuar konsultuam me Komisionerin e Mbrojtjes të të Dhënave Personale, sa na lejon legjislacioni në fuqi që ta kontaktojmë ne zgjedhësin të parin? Sepse thamë që nëse ai kërkon ndihmë në një nga pesë format që ne kemi, ne i përgjigjemi. Në fakt deklaratën, në politikën e privatësisë së kësaj platforme zgjedhësi e ka dhënë numrin e telefonit ose emailin, dakordësinë që ne ta përdorim këtë për dy arsye e para që t'i shkojë kodi unik i përkohshëm, që është një

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

nga format të autentifikimit, e dyta që ai të marrë informacion për shqyrtimin e kërkesës së tij, pra është pranuar apo është refuzuar kërkesa. Ne nuk kemi të drejtë të përdorim numrin e tij të telefonit apo emailin për t'i dërguar mesazhe të tjera që nuk lidhen me këto të dy veprime. Gjithsesi për të gjetur një formë kemi ndryshuar tekstin që i shkon zgjedhësve të cilët e kanë kërkesën jo të plotë dhe në mesazhin, në tekstin sms që i shkon dhe që i shkon në telefon ose në email. I kemi thënë: “I/ë nderuar, kërkesa juaj nuk është e plotë, ju lutemi të riaplikoni përsëri deri në datën 4 mars, nëse keni nevojë për ndihmë klikoni në këtë link”. Ai link e çon zgjedhësin diku në faqen e KQZ-së, për të rezervuar një telefonatë me KQZ-në. Ai zgjedh ditën, datën, zgjedh orën kur dëshiron që KQZ ta telefonojë mbrapsht. Kemi vënë një indikative, një kohë dhjetë minuta për çdo telefonatë, presim tre telefonata simultane që do të thotë diku 6 për një orë. Kjo mundësi është aktive nga dje në sistem për zgjedhësit. Ata rezervojnë një telefonatë me ne, ne i i kontaktojmë dhe në këtë formë është ai që ka kërkuar që ne ta marrim në telefon, ai deklaron të dhënat e veta identifikuese, emër, mbiemër, jep numrin e telefonit ku ne ta kontaktojmë. Ka zgjedhur datën, zgjedh orën, nëse do ka dhe mundësi të përshkruajë çështjen, pra ai mund të thotë shikoni kam vështirësi në autentifikimin ose nuk po gjej një dokument provues dhe ju po më refuzoni, por gjithsesi edhe nëse nuk e bën këtë përshkrim, kjo sqarohet gjatë telefonatës. Nga dje kjo forma e dytë që ju thashë është aktive , ndërkohë kontakti në facebook, messenger ka rreth një javë që është aktiv, në mos gaboj ekzaktësisht.

**Z. M. Çakaj:** Qartë. Atëherë gjithë relatimi juaj unë kuptova dy gjëra, së pari kuptova që nga procesi i auditimit të brendshëm, personi, aplikanti me numrin më të madh të herëve të refuzuara është 22 herë dhe 22 herë, se 21 herë refuzuar, herën e 22 ka aplikuar 21 herë është refuzuar, herën e 22 aplikuesi vetë e ka kuptuar se çfarë

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

duhet të hidhte. Pra i pakontaktuar nga KQZ dhe e ka kryer, e ka realizuar aplikimin me sukses, se pari. Së dyti kjo zgjidhje, e cila qenka bërë edhe me ndihmën e Komisionerit për të Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pra që nuk e kontaktoni ju, por hapni një dritare dhe ju kontakton ai, nuk mund të bëhej që në fillim? Sepse praktikisht jemi gati, sot është data 13, jemi gati 20 ditë, ndoshta dhe më pak nga përfundimi i procesit të aplikimeve. Ndërkohë që ka kaluar më shumë se një muaj, pra ka kaluar diku 32 ditë nga fillimi i procesit të aplikimeve për regjistrim dhe ne e kemi shtruar herë pas here, të paktën unë dhe kolegja Vukaj, këtë kërkesë. A e shihni të arsyeshme, së pari ndërveprimin, së dyti thjeshtësimin e procesit? Ndërsa, besoj nuk ka nevojë për përgjigje se është e qartë përgjigja për këtë pjesë, ishte më shumë konstatim, retorikë kjo çështje. Ndërsa në lidhje me një emision që ka publikuar disa të dhëna dhe emision investigativ, i cili ka publikuar disa të dhëna ku me ose padashje implikohet dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pra të gjithë ne, pavarësisht se në mënyrë të drejtpërdrejtë implikohet KSHZ dhe Drejtoria e Votimit nga Jashtë, kur dikush në mënyrë të pautorizuar prezantohet si përfaqësues i KQZ-së por ne duhet të na dhembti që të gjithëve. Unë do të doja ta shtjelloja dhe ta diskutonim këtë gjë në momentin që do të diskutohen dhe shqyrtohen vendimi nr. 2 sepse në gjykimin tim jo vetëm kjo gjë është veprimtari e ndaluar po kjo është kriminale dhe unë personalisht do ta shjelloj më pas, nuk do të mjaftohesha vetëm me një deklaratë distancimi nga këto veprime, ajo duhet të niste kryesisht hetimi dhe sigurisht të dhëna me zë e figurë, qartë të pastra, patjetër ka nevojë për të bërë një kallëzim penal. Jo më larg se sot po shikonim informacionin KSHZ ka takuar kreun e SPAK, Altin Dumani, fare mirë këtë mund t'ia kishte përcjellë. Jo, jo, shiko ne jemi organi që ndërveprojmë me njëri-tjetrin, nuk e kemi këtë informacion, se këtu nuk na denjon të na vijë KSHZ. Madje edhe kur shkon në Parlament, edhe kur ndan opinione sesi duhet të ndryshohet Kodi Zgjedhor është kërkesë e kahershme kjo e

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

jona, kemi prej një viti, do të duhet të, në bazë të Kodit Zgjedhor të konsultohet me të dyja edhe me KAS-in, edhe me Komisionin Rregullator, megjithatë kjo është jashtë rendit të ditës. Kur të vijë momenti do ta diskutojmë, në mbështetje të Kodit Zgjedhor për të bërë dhe propozime, po kjo është tjetër gjë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit! Domethënë këto ishin diskutimet në parim për projektaktin. Kolegë keni diçka në parim? Përfaqësuesit e partive politike në parim për projektaktin? Nuk ka. Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro: 5 (z. I. Nano, z. D. Çaka, z. A. Çela, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s'ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

Fillojmë atëherë shqyrtimin e përmbajtjes së projektvendimit. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator vendosi:

“Në vendimin nr.11, vendosi 1”, (si kreu I është këtu, kur të zbardhet vendimi kam disa gjëra për teknikën),

“Në vendimin nr. 11, datë 1.11.2024 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e listës së dokumentacionit që kërkohet për të vërtetuar qëndrimin e zgjedhësit shqiptar që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim regjistrimin në listën e zgjedhësve jashtë vendit”, bëhen këto ndryshime:

1. Pas pikës 1, (po e them që këtu sesi duhet bërë) shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Dokumenti i cili vërteton, provon adresën e deklaruar qëndrimin e zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo

**Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

anëtar i familjes së personit në emër të të cilit është dokumenti. Në këtë rast personi që ngarkon dokumentin e adresës në PER ngarkon së bashku me të edhe një nga dokumentet vijuese:

- a) certifikatë familjare të personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
  - b) certifikatë personale e personit që aplikon në PER, e cila tregon lidhjen me personin në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
  - c) një nga dokumentet shqiptare të identitetit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës;
  - ç) një deklaratë të lëshuar nga personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës”.
- Atëherë fillojmë diskutimin për këtë pikë, e cila edhe duke e lexuar vlerësoj që ka nevojë të riformulohet. Po zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë në kuadër të riformulimit edhe përmirësimit të kushteve për ta aksesuar më mirë dhe për ta bërë efektive këtë qasje të re ose këtë propozim, unë kam mendimin që duhet një ridraftim i pikës së parë. Po, riformulim dhe në të njëjtën kohë konsiderojeni propozim këtë riformulim të pikës së parë që këtu është pika 2. Kam një shtesë dhe në të njëjtën kohë edhe një riformulim dhe shtesa në germën “ç”. Këtë propozim, po vijoj ta lexoj si më poshtë.

**Znj. I. Nano:** Po zonja Vukaj propozimi për këtë pikë!

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, duke qenë që sinkronizimi do të ishte më e mira në këtë akt, bashkë me përmbajtjen e gjithë pikave dhe germave që rrjedhin më poshtë, duhet të fillojë të tregohet në pikën kryesore se çfarë duhet të synojmë të arrijmë, ndaj unë mendoj që draftimi që do të lexoj i shërben këtij procesi dhe kësaj risie. Atëherë:


*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike  
të Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

“Dokumenti i cili provon adresën e qëndrimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes, të atij personi, në emër të të cilit rezulton të jetë dokumenti provues që identifikon adresën jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë rast personi që përdor adresën e anëtarit të familjes së tij plotëson në PER lidhjen me mbajtësin e adresës dhe ngarkon në PER edhe dokumente të tjera që vërtetojnë lidhjen familjare me mbajtësin e adresës kryesor si vijon”, germa “a” dhe “b” mbeten të njëjta dhe unë shtoj germën “c”, si propozim dhe shtesë të re dhe them: “Çdo certifikatë tjetër që tregon lidhjen me mbajtësin e adresës”, kjo për faktin që certifikatat janë një mori certifikatash, të cilat nuk janë vetëm ajo familjare apo personale, por kemi dhe certifikata të tjera, për shembull të trungut familjar, të cilat dëshmojnë për lidhje të tjera, ndoshta jo të shkallës së parë, por lidhje të cilat janë përtej shkallës së parë.

*Zbardhi materialin audio  
Adriana DUKA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

Riformulimi i germës “ç” është sa më poshtë: “Një deklaratë të nënshkruar nga personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës, teksti i deklaratës miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendoset në PER si tekst i detyrueshëm, të cilit duhet t’i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë, nënshkruhet prej tij dhe ngarkohet së bashku me dokumentin e identifikimit në PER. Në çdo rast, numri i personave që lejohen për t’u regjistruar në një adresë tjetër, nuk mund të jetë më shumë se 5 persona, përveç mbajtësit të adresës.”. Pasja e një teksti të gatshëm në PER do ta bënte më të lehtë dhe të unifikuar procesin e deklarimit dhe të servirjes së adresës së një personi tjetër me lidhje gjaku në këtë rast. Pra, mjafton që në PER, besoj se nga administrata është e realizueshme ngarkimi i një linku, i cili që në krye të faqes, kur hapet platforma PER, përmban tekstin që duhet të kopjojë, në një farë mënyre, të shkruajë deklaruesi për dhënien e adresës një personi tjetër dhe ky tekst, pasi të nënshkruhet prej tij, pra pasi të kopjohet siç shfaqet në platformën PER, do të nënshkruhet nga adresëmbajtësi kryesor dhe do të ngarkohet sërish në PER, me qëllim që t’i shërbejë adresëdhënësit, pra, personit që po përdor adresën për qëllime regjistrimi e më pas votimi. Kaq kisha për këtë pikë. Më pas do të vijojmë me propozimet e tjera.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj, përpara së të kaloj për votim këtë pikë, së pari, në paragrafin e parë, sepse ju ma keni dhënë edhe përmbajtjen e propozimit tuaj, folët për adresëmbajtësin kryesor ose mbajtësin e adresës kryesore. E para kjo. E dyta, do të doja të pyesja zonjën Josifi, ndërhyrjet që propozon zonja Vukaj kanë implikime teknike, janë dy të tilla. E para kemi vendosjen në PER të lidhjes së zgjedhësit që aplikon me mbajtësin e adresës. Pra, fakti që kjo kërkohet, sipas propozimit të zonjës Vukaj, të vendoset në PER, është një ndërhyrje. E dyta, është kjo deklaratë. Mund të na thoni teknikisht këto implikime janë të mundshme, kërkojnë kohë? Pa dyshim, në vetvete akti, por edhe propozimi që po bën zonja

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

Vukaj tani janë në funksion të lehtësimit të procesit të regjistrimit për shtetasit që kanë pasur vështirësi për shkak se nuk kanë pasur asnjë nga dokumentet që ne kemi miratuar më herët, që vërtetonin adresën e tyre, nuk e kanë pasur në emrin e vet. Për këto dy ndërhyrje.

**Znj. J. Josifi:** Është e mundur në platformë që të ngarkohet edhe një dokument që provon lidhjen, pra, dokumentet e listuara në këtë pikë që propozohet të shtohet në gerrat “a”, “b”, “c” dhe “ç”. Nuk e di nëse me këtë nënkuptohet që deklarimi i lidhjes ka nevojë të specifikohet cila është lidhja, apo thjesht që dokumenti...

**Znj. I. Nano:** Në një deklaram teksti, pra ta deklaroj lidhjen.

**Znj. J. Josifi:** Llojin konkret të lidhjes. Pra, të thotë që po përdor dokumentin e bashkëshortit, apo thjesht të thotë që ky është dokumenti i një personi të lidhur dhe ka pastaj dokumentin e lidhjes.

**Znj. H. Vukaj:** Së pari, duhet të ndajmë ku qëndron thembra e Akilit, pra ajo pjesa kroçale që të unifikohet dhe të çlirohet disi ky proces edhe për banues të tjerë në atë adresë duhet që ta fusim në kornizë përmes kësaj deklarate, pra që t'i japim një lloj legjitimiteti, pra kjo është një adresë e qenësishme, kjo është ideja, ti nuk po e shpenzon kot shtetin shqiptar për dy-tre zarfë që do të vijnë në adresën tënde, nuk do bëhet spedicioni kot, për ta siguruar që ti do të jesh votues. Duhet kjo deklaratë. Me qëllim që ne të unifikojmë dhe të lehtësojmë punën e operatorëve, duhet që kjo deklaratë të marrë konturet e seriozitetit përmes një teksti që e unifikon dhe e miraton Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Këtë tekst ti e lidh aty në faqen primare të PER-it, me sa folëm, teknikisht kjo është e bëshme, ose e shfaq në formën e linkun, ku secili të shkojë në link dhe ta shohë

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

tekstin dhe më pas këtë tekst ta shkruajë në një fletë, të cilën e nënshkruan dhe, pasi e nënshkruan, e skanon përsëri dhe e ngarkon në PER. Kjo është e bëshme.

**Znj. J. Josifi:** Po, po.

**Znj. H. Vukaj:** Sigurisht që do të marrë kohën e sigurimit të teknikalitetit të realizuar 100% dhe kjo është e pranueshme deri diku. Kjo është risia.

**Znj. J. Josifi:** Po, kjo është e bëshme, do të na marrë pak kohë ta zhvillojmë dhe zgjedhësi ta ketë të mundur në platformë *live*, ndryshimi i dytë po e quaj kështu, duke iu referuar asaj që pyeti zonja Nano, por për ndryshimin e parë e kisha pyetjen, e kam thjesht në nivel praktik, pra thuhet që ai duhet të deklarojë lidhjen. Mjafton të thotë që do të përdor dokumentin e një personi të lidhur, apo edhe duhet ta specifikojë?

**Znj. I. Nano:** Kur të deklaroj lidhjen, do të thotë biri, bija, ati, nëna.

**Znj. H. Vukaj:** Nipi, thjeshtri, ka disa lidhje familjare, vjehri, vjehrra, që do t'i deklaroj aty, të ketë hapësirën, dritaren, vjehri i X-it, ndërkohë provon me certifikata deri në momentin që del që është vjehri, me certifikatë të bijës e më pas me certifikatë martesore të saj. Pra, lidhen zinxhir të gjitha dokumentet provues me atë të deklaruar më lart.

**Znj. J. Josifi:** Kjo na shton një fushë tekst, ku zgjedhësi duhet të thotë që unë po përdor dokumentin e babait, bashkëshortit, të nuses, në këtë kuptim, që ne do të duhet ta shohim këtë në ekran. Pra, e kemi hapësirën ta akomodojmë në një formë të qartë.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Znj. H. Vukaj:** Kjo do të lehtësonte punën e operatorit që t'i referohet specifikimit të lidhjes, pra çfarë e kam unë adresëmbajtësin, e kam dhëndër, e kam vëlla, e kam kunat, e kam diçka dhe kjo më pas ty të çon te dokumentet, pra ballafaqimi i këtij deklarami me dokumentacionin, certifikatat e vërtetojnë këtë lidhje që unë e kam djalë teze.

**Znj. J. Josifi:** Dakord. Vetëm një propozim teknik që ne t'ia lëmë të hapur zgjedhësit ta shënojë këtë lidhje.

**Znj. H. Vukaj:** Të hapur.

**Znj. J. Josifi:** Se përndryshe po e bëmë listë, nuk bëjmë dot një listë shteruese.

**Znj. H. Vukaj:** Jo listë, sepse nuk shteron lidhja, ne nuk parashikojmë dot se çfarë lidhje mund të kenë. Mund të jetë edhe kushëriri i dytë.

**Znj. I. Nano:** Votojmë propozimin e zonjës Vukaj. Po, zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Te pjesa e numrit të personave, të cilët ne i kufizojmë në një adresë, tek akti bazë, pra te vendimi nr. 11 i bie që të kemi një përplasje midis dy dispozitave, aty kemi një numër 6 dhe lejojmë edhe më shumë nëse provohet me dokumentacion shtesë. Ndërkohë, unë e kuptoj këtë lidhjen këtu që mund të jetë 5 duke ecur me parimin 5 shtesë edhe zgjedhësi, pra vetëmbajtësi i adresës. Por mbajtësin e adresës ne nuk e detyrojmë dot që të jetë automatikisht kërkues në listë, se mund të mos jetë dhe ne i bie që në një vend do ta kemi 5, në një vend 6 dhe brenda së njëjtës kemi përplasje dispozitash. Mbase do ta çojmë këtë pikë te referenca.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Z. M. Çakaj:** E riformulojmë ndryshe. Pra, fjalia e fundit “Në çdo rast numri i personave të regjistruar në një adresë jashtë vendit nuk është më shumë se 6. Vetëm për shkaqe të përligjura, do të regjistrohen më shumë se 6.”.

**Z. D. Çaka:** Ajo çfarë unë propozoj është që të jetë i njëjti unifikim me pikën.

**Z. M. Çakaj:** Po, po, “Në çdo rast, numri maksimal i personave të lejuar për t’u regjistruar në një adresë do të jetë 6. Vetëm për shkaqe të përligjura, do të jetë më shumë 6.”.

**Znj. I. Nano:** Jemi në akt tjetër, e kemi te akti i regjistrimit.

**Z. D. Çaka:** Tek akti i dokumentacionit.

**Znj. I. Nano:** Nuk e kemi te akti i dokumentacionit.

**Z. D. Çaka:** Te ky e kemi.

**Znj. I. Nano:** Te ky e kemi. Nuk mund të përsërisim të njëjtën gjë, do ta bëjmë me referencë.

**Znj. H. Vukaj:** E riformulojmë tani. “Në çdo rast numri i personave që lejohet për t’u regjistruar në një adresë tjetër...”

**Znj. I. Nano:** Jo “tjetër”.

**Znj. H. Vukaj:** Ok “...në një adresë nuk mund të jetë më shumë se 6, përveç rasteve të përligjura.”.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Znj. I. Nano:** Zonja Xhina ka propozim për këtë nen. Si e mendoni ju riformulimin?

**Znj. E. Xhina:** Jo, më shumë për efekt procesverbali, se e dimë që rastet kur ka paqartësi hapen procesverbalet dhe këto pyetje që bëjmë mund të ndihmojnë për gjetjen e përgjigjeve. Dua të qartësoj diçka. Lidhur me rastin e parë, që u bë propozimi, kur janë anëtarë të një familjeje, ata që do të hedhin dokumentin që ka pasur kryefamiljari adresën, kuptohet që ai personi i pestë apo i gjashtë është votues vetë, sepse rrjedhimisht kështu shkon logjika, por te rasti i dytë, kur nuk kanë lidhje familjare, personi që ka adresën mund të mos jetë votues? Pra. Mund të jetë që jeton me qira në shtëpinë e një italiani, po them kot.

**Znj. I. Nano:** Nuk është kusht.

**Znj. E. Xhina:** Pikërisht këtë duhet ta zbardhim, edhe në procesverbal qoftë, sepse mund të ndodhemi para këtij rasti. Pyetja e dytë që kisha: themi në këtë rast personi që përdor adresën e anëtarit të familjes specifikon, plotëson në PER lidhjen me adresëmbajtësin. Siç u tha, do të bëhet një fushë specifike. Por ky dokumenti dhe deklarata që ai plotëson, që do të kemi një deklaratë tip, do të ketë sërish kërkesë për të plotësuar lidhjen me adresëmbajtësin? Pra, do të ketë edhe te deklarata fushë, apo do të ketë vetëm fushë dhe jo te deklarata lidhje?

**Znj. I. Nano:** Po them si e mendoj unë këtë, sepse kjo është çështje e Komisionerit. Le ta shohim në dy kahe. Këtu kemi personin që dëshiron të përdor adresën e dikujt tjetër, anëtarit të familjes dhe do t'i duhet atij të deklarojë lidhjen me mbajtësin e adresës. Ndërkohë, nga ana tjetër, deklarimi bëhet nga ai që mban adresën ose mbajtësi i adresës do të bëjë deklarimin që ky personi jeton në adresën time. Mua personalisht në këtë moment që flasim nuk më duket e domosdoshme

që deklaruesi njëri do të thotë xhaxha e tjetri do të thotë nip pastaj, varet si i quajnë në krahina të ndryshme të Shqipërisë. Për sa kohë ne e kemi të hapur edhe në pikën më tej, që kemi propozim, që mund të mos jetë domosdoshmërisht lidhje familjare, mjafton që ai që ndërvepron në PER...

**Z. M. Çakaj:** Me këtë logjikë, do të kenë të dy dokumente. Do të ketë hapësirë për të deklaruar cilësimin konkret.

**Znj. I. Nano:** Tek ai që deklaron në PER, sepse në PER deklarimin e bën personi që s'ka adresë të provuar, jo ai tjetri.

**Znj. H. Vukaj:** Ai personi që nuk ka adresë të provuar, do të vendosë fillimisht cilësimin se çfarë e ka adresëmbajtësin, pastaj do të marrë deklaratën e nënshkruar nga ky adresëmbajtës, sepse lidhja është serioze. Jo, nuk duhet ta deklarojë ai, duhet vetëm të ngarkohet...

**Z. M. Çakaj:** Te formati do deklarohej, sepse formati do të jetë standard sipas formatit të miratuar nga KSHZ-ja. Te formati patjetër duhet deklaruar lidhja se pastaj i bie ta fusim në kolaps operatorin.

**Znj. H. Vukaj:** Lind pyetja të bëjmë dy deklarime: deklarime në PER...

**Znj. J. Josifi:** Ne teknikisht për ta realizuar sa më shpejt kemi rastin e dytë, që lidhja të deklarohej në tekstin e deklaratës. Këtë ne e kemi më të thjeshtë, më të shpejtë për ta implementuar, pra që lidhja të deklarohej në tekstin e deklaratës që do të miratohet. Pra, ky teksti i deklaratës le të ketë në brendësi të tij edhe lidhjen të specifikuar, sepse kështu i bie është dy herë, është një herë në PER, ta thotë, ta

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

shkruajë në një fushë, e ka sërish edhe brenda deklaratës. Bëjmë o njërën, o tjetrën., nëse e gjykoni...

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë i bie që tek teksti që do të prodhojë KSHZ-ja me vendimin e tij te formati të lërë hapësirën bosh dhe në kllapa të sqarojë lidhjen, llojin e lidhjes me adresëmbajtësin.

**Znj. I. Nano:** Prurësi, në këtë rast është ai që mban adresën dhe deklaron për personat e tjerë lidhur me të.

**Z. M. Çakaj:** Edhe diçka: Siç ramë dakord, siç e bëri kolegja Vukaj propozimin, teksti i deklaratës do të jetë në PER.

**Znj. I. Nano:** Në PER e kemi.

**Z. M. Çakaj:** Me qëllim thjeshtëzimin, lehtësimin e procesit, në faqen e parë të PER-it të jetë një shkrim orientues ku mund të përcaktohet që këtu mund të gjeni tekstin e deklaratës nga KSHZ-ja në rastin kur nuk është adresa juaj.

**Znj. H. Vukaj:** Sigurisht, duhet të keni parasysh, kjo i përket Komisionerit, kur ta miratojë, që ky tekst duhet të jete minimalist, por esencial në kuptimin që ti mban përgjegjësi nëse mashtron apo je në kapërcim të rrethanës së sinqeritetit, po përdorim zhargonin letrar.

**Znj. I. Nano:** Zonja Xhina.

**Znj. E. Xhina:** Thjesht teknikë legislative, meqenëse e kemi përpara tekstin. Them: "Dokumenti, i cili vërteton, provon adresën e deklaruar qëndrimin e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

zgjedhësit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes së atij personit në emër të të cilit rezulton të jetë dokumenti” dhe përsëritet prapë “provues, identifikon adresën”. Pra, dy herë keni përsëritur të njëjtën gjë, mendoj për teknikë dhe për cilësi.

**Znj. H. Vukaj:** Nuk është e tepërt, sepse sa më shumë të sqarosh në këtë fazë...

**Znj. E. Xhina:** Është përsëritje, por gjithsesi shikojeni vetë.

**Znj. H. Vukaj:** Nuk na rëndon fare përsëritja, përveçse, nëse e dëgjuat propozimin, “dokumenti, i cili provon”, është hequr “provon”.

**Znj. I. Nano:** Është hequr fjala “vërteton”.

**Znj. H. Vukaj:** Më fal, “vërteton”, është “provon”.

**Znj. I. Nano:** Do të heqim nga propozimi deklarin në PER të lidhjes me anëtarin, do jetë tek teksti thamë. Nëse më lejoni, 3 minuta ta ndërpresim mbledhjen për të bërë një konsultim me njëri-tjetrin.

**Rifillon seanca**

**Ora 16:19**

**Znj. I. Nano:** Pas një konsultimi të shkurtër me njëri-tjetrin, zonja Vukaj edhe një herë ju lutem propozimin tuaj të riformuluar për ta votuar.

**Znj. H. Vukaj:** Pas konsultimit me ju, të nderuar kolegë, dhe në të njëjtën kohë pas konsultimit me aktin që kemi miratuar më herët, për të mos rënë në përsëritje të propozimit, mendoj ta përsëris edhe një herë propozimin tim duke e riformuluar

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

pa përsëritje. Atëherë pika 1.1 do të jetë: “Dokumenti, i cili provon adresën e qëndrimit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë mund të ngarkohet në PER nga çdo anëtar i familjes së personit në emër të të cilit rezulton të jetë dokumenti i adresës. Në këtë rast personi që përdor adresën e anëtarit të familjes së tij ngarkon në PER dokumentet që vërtetojnë lidhjen familjare me adresëmbajtësin ose mbajtësin e adresës si vijon.” Më pas germa “c” mbetet e njëjtë, ndërsa te germa “ç” hiqet paragrafi i fundit, fjalia e fundit, meqenëse krijon përsëritje me atë që kemi miratuar më herët në vendimin nr. 11 dhe ajo është shteruese për gjitha rastet e këtij akti, mendoj që të bjerë dhe të mbetet pa këtë fjali.

**Znj. I. Nano:** Pra të përfundojë së bashku me dokumentin e identifikimit në PER. Votojmë pikën 1.1, e cila shtohet pas pikës 1 të kreut 2 të vendimit nr.11 sipas këtij formulimi që sapo u lexua nga kolegja?

**Kush është dakord, kolegë?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s’ka!

**Miratohet me 5 vota pro!**

Vazhdojmë me propozimin. Po e them që këtu atë që thashë më herët. Pas pikës 1.1 shtohet pika 1.2 me këtë përmbajtje: “Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë, të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast personi në emër të të cilit është dokumenti i adresës duhet të lëshojë një deklaratë sipas së cilës deklaron se aplikuesi është banues në të njëjtën adresë me të. Në këtë rast aplikuesi duhet të ngarkojë në sistem këtë deklaratë bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës.”. Mendoj që nën dritën e asaj çka miratuar tani, do të duhet të riformulohet edhe kjo pikë. Zonja Vukaj.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Znj. H. Vukaj:** Reformulimi që do të sjell si propozim është: “Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë, të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast personi, në emër të të cilit rezulton dokumenti i adresës, duhet të lëshojë një deklaratë sipas të cilës deklaron se aplikuesi është banues në të njëjtën adresë me të. Aplikuesi ngarkon në sistem këtë deklaratë të nënshkruar prej mbajtësit të adresës bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës. Teksti i deklaratës miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendoset në PER si tekst i detyrueshëm, të cilit duhet t’i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë, nënshkruhet prej tij dhe ngarkohet së bashku me dokumentin e identifikimit në PER”, pra dokumentin e identifikimit të adresëmbajtësit. Në rregull, meqenëse kjo krijoi përsëritje edhe këtu do të bjerë, meqenëse ju keni përpara një draft të mëparshëm. Ky do të jetë propozimi dhe shpresoj zgjidhëm edhe nga ana teknike e platformës, që mund të krijonte pengesa dhe vonesë faktin që nuk do të kemi më një dritare ku të specifikohet lidhja, por lidhja do t’i mundësohet të specifikohet në draftin që do të miratojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Pra, teksti do të ketë një hapësirë bosh dhe në kllapa të ketë “Specifiko lidhjen”.

**Znj. I. Nano:** Unë kam një pyetje për administratën. Zonja Josifi, në këtë rastin e dytë, edhe në të parin, kemi më shumë se dy dokumente që kërkohen të ngarkohen në PER. Kemi një dokument që përmban adresën e mbajtësit të adresës, kemi deklaratën, kemi dokument identifikimi të personit, në emër të cilit është adresa. Implikime teknike?

**Z. J. Josifi:** Nuk mendoj që jemi më në kushtet për të shtuar dokumente që ngarkohen, pra si numër, pra aktualisht jemi deri në 2 dhe deklarata, e cila do të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

duhet të shoqërohet me dokumentin e identifikimit të personit, që në praktikë personi do ta shkruaj atë dhe do t'i bëjë foto për ta ngarkuar në PER, do të duhet ta vendosë aty edhe dokumentin e identifikimit, se po flasim për një faqe, sepse ndryshe nuk kemi mundësi të shtojmë *file* të rinj.

**Znj. H. Vukaj:** Në momentin që ju pyetëm nuk na e nxorët problem për sa kohë në fashën e parë ai do të ngarkojë 3 certifikata.

**Znj. J. Josifi:** Njërën nga ato.

**Znj. H. Vukaj:** Më falni, për të realizuar vërtetësinë e lidhjes, unë do të ngarkoj certifikatën e trungut familjar, ku vërtetohet që nëna ime dhe nëna jote janë motra dhe më pas një certifikatë tjetër që të vërtetojë që jam bir i kësaj nëne, e cila është një të njëjtën kohë tezja ime.

**Znj. I. Nano:** Mjafton edhe deklaratat te pjesa e parë.

**Znj. H. Vukaj:** Deklarata duhet të mbështetet me dokumentet. Ideja është që me këtë çfarë po sillni si përgjigje, po ia limitoni. Nga njëra anë ne po lehtësojmë që të plotësohet kjo deklaratë dhe të krijohet mundësia e përdorimit të adresës së një personi tjetër, jo me lidhje gjaku, pastaj themi që, shiko, është e pamundur që nga ana teknike të realizohet ngarkimi i dokumentit të identitetit të atij personi. Pa dokument identiteti të atij personi?

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj, prandaj janë dy pjesë të ndara. Një për anëtarët e familjes, një për anëtarët që nuk janë të familjes. Për anëtarët e familjes është e mjaftueshme edhe një certifikatë familjare, dhe një nga ato dokumente që sapo

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

miratuam. Për ata që nuk janë të familjes, nuk duhet ta vërtetojmë kështu në mënyrë indirekt.

**Znj. H. Vukaj:** Po në rastin kur nuk është e mjaftueshme?

**Znj. I. Nano:** Mjafton deklarata.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë pse e ngarkon ti, më vërteto deklaratën tënde me dokumentacion.

**Znj. I. Nano:** Kush nuk është në një certifikatë familjare...

**Znj. H. Vukaj:** Zonja Josifi e pranoi pak më parë kur u bë diskutimi në lidhje me anën teknike.

**Z. M. Çakaj:** Kam një propozim. Për t'i dhënë zgjidhje kësaj, PER-in, me sa duket, e kemi bërë kështu si e kemi bërë që në fillim...

**Znj. J. Josifi:** Konform rregullave.

**Z. M. Çakaj:** Patjetër, që merr vetëm 2.

**Znj. I. Nano:** Ato rregullat janë të paktën një nga dokumentet. Kur themi “ të paktën” mund të jenë 2, 3, 5, 15.

**Z. M. Çakaj:** Ideja është e kemi bërë kështu si e kemi bërë. Për ta zgjidhur situatën, sepse ju po konfirmoni që teknikisht është e pamundur të ngarkosh më shumë se 2 dokumente në PER, apo jo?

*Zbardhi materialin audio  
Alma KOLA*



**Z. J. Josifi:** Në fillim ne e kishim një dokument të ngarkohej në PER. Për t'iu përshtatur nevojës, kemi mundësuar që të ngarkohen dy dokumente.

**Z. M. Çakaj:** Keni mundësuar. Tani, në rastin konkret na bëhen më shumë se dy dokumente.

**Z. J. Josifi:** Mendoj se nuk ka pse, për një arsye. Duke marrë pikën e parë që personat kanë lidhje familjare, pra bashkëshortja do të përdorë kontratën e shtëpisë së bashkëshortit.

**Znj. H. Vukaj:** Ky është më klasiku.

**Znj. J. Josifi:** Do të ngarkojë certifikatën familjare ose martesore...

**Znj. H. Vukaj:** Kur ke persona të tjerë, të cilët jetojnë në këtë familje, që nuk janë në lidhjen e drejtpërdrejtë, pra në atë lidhjen e thjeshtë, klasike.

**Znj. J. Josifi:** Është pika 2, germa "b", pra, nëse, po themi, vjehrra qëndron në shtëpinë e dhëndrit, do të duhet të ngarkojë dokumentin e shtëpisë, që është në emër të dhëndrit dhe certifikatën personale të dhëndrit ose foto të ID-së të tij.

**Z. M. Çakaj:** Si lidhet ai? Nipi, si lidhet? E thënë kështu, jam shumë dakord, por do ta refuzojë ai.

**Znj. J. Josifi:** Në këtë rast, kështu siç e kemi sjellë propozimin, ai duhet të ngarkojë një nga katër dokumentet që janë nga germa "a" në "ç".

**Z. M. Çakaj:** Pra, mjafton deklarata.

**Znj. H. Vukaj:** Pak më parë ju thatë që këtë e transpozojmë te varianti i dytë.

**Znj. J. Josifi:** Mjafton deklarata.

**Znj. H. Vukaj:** Pak më parë ju thatë që këtë rastin e vjehrrës te dhëndri e transpozojmë te varianti 2, pra jo atë me lidhje gjaku, që nuk hyn aty.

**Znj. I. Nano:** Familje është tjetër gjë.

**Z. M. Çakaj:** Dakord, nëse e mundëson deklarata, atëherë riformulojmë fjalinë e fundit. “Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë, nënshkruhet prej tij, ngarkohet së bashku me dokumentin e identifikimit në PER në të njëjtën foto”.

**Znj. I. Nano:** Mund të jetë “S’kam”.

**Z. M. Çakaj:** “S’kam”. Në të njëjtin dokument kemi edhe tekstin e deklaratës, edhe foto ID.

**Znj. I. Nano:** Atëherë gjeni fjalën e përshtatshme në të njëjtën se nuk mund ta ....

**Z. M. Çakaj:** Dhe adresoni të gjithë shqetësimin, edhe të koleges Vukaj, edhe të funksionalitetit, thjeshtësisë dhe qëllimit të miratimit të këtyre ndryshimeve.

**Znj. I. Nano:** Ngarkohet në të njëjtin dokument apo në të njëjtin *file*. Po *file* nuk mund ta lëmë...

**Znj. J. Josifi:** Në të njëjtin skedar.

**Znj. I. Nano:** Ne po flasim për njerëz, me respektin më të madh për të gjithë bashkëkombëtasit tanë, që nuk kanë gjetur një dokument, po i the edhe “skedar”...

**Znj. J. Josifi:** Më duhet të bëjmë një komunikim publik për ta shpjeguar këtë mundësi të re.

**Z. M. Çakaj:** Përpara se ta hedhim në votim, të jemi të gjithë të qartë. Bëhet fjalë për dy raste. Ndryshimet sot konsistojnë në dy raste të paraqitjes së dokumentacionit. Bëhet fjalë për aplikantët kur nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë aplikanti me dokumentin që provon adresën jashtë dhe rasti A kur është në një familje, por mund ta ketë dokumentin e adresës kryefamiljari, pra certifikatë pronësie, kontratë qiraje, faturë drita e uji etj., etj., ky është rasti i familjes dhe rasti B kur është përtej familjes dhe këtu futet edhe nipi, edhe mbesa, edhe vjehri dhe vjehrra, edhe persona të tjerë që bashkëjetojnë...

**Znj. I. Nano:** Vjehri dhe vjehrra mund të jenë në të njëjtën certifikatë familjare.

**Z. M. Çakaj:** Mund të jenë, mund të mos jenë. Nëse nuk e provojmë, meqë nuk ngarkojmë më shumë se një dokument, nuk na e lejon PER-i. Rasti i dytë është kur kemi këtë kategori njerëzish dhe kjo provohet: 1. Me dokumentin e adresëmbajtësit dhe 2. Me deklaratën. Nuk ka nevojë për dokument tjetër.

**Znj. I. Nano:** Të dyja duhet të jenë në një skedar.

**Z. M. Çakaj:** Nuk ka nevojë për dokument tjetër që të provojë lidhjen ndërmjet tyre. Vetëm me vetëdeklarim. Jemi shumë të qartë dhe shumë dakord.

**Znj. I. Nano:** “Dhe ngarkohet në një skedar së bashku me dokumentin e identifikimit në PER” “dhe ngarkohet në PER së bashku me dokumentin e identifikimit në të njëjtin skedar...” Merrni kohë 2 minuta dhe saktësojeni.

**Znj. J. Josifi:** Në propozimin tonë fjalë e tretë, aty ku ne themi pas pikës 2 të shtuar, shtohet pika 3 me këtë përmbajtje, po kaloj direkt te fjalë e fundit e kësaj shtese, ne themi: “në këtë rast aplikuesi duhet të ngarkojë në sistem...”, pra në PER mund të themi tani “...këtë deklaratë...”

**Znj. I. Nano:** “Tekstin e deklaratës” do të duhet ta themi tani...

**Znj. H. Vukaj:** Po, ajo është teksti i deklaratës, shkruhet.

**Znj. J. Josifi:** Deklaratë është ajo se ai do ta shkruajë me dorë.

**Znj. I. Nano:** Po pra tekst...

**Znj. J. Josifi:** Bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është dokumenti adresës, në një skedar ose në një hapësirë. Si ta kuptojnë ata? Teknikisht korrekt. Në të njëjtin format.

**Z. M. Çakaj:** Bëjeni të thjeshtë, në të njëjtin dokument. Në të njëjtën foto, në të njëjtin dokument.

**Znj. J. Josifi:** Ne kështu e kemi thënë. Bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është, pra jam e sigurt që ata vetë do ta venë këte ID, në krah të deklaratës. Po flasim që dokumenti identifikimit do të jetë o pashaporta, o letërnjoftimi, pra. Nuk është se ai ka tre fletë.



**Z. M. Çakaj:** Po pra, po kjo siguria 70378..., kjo siguria. Të thjeshtë...

**Znj. J. Josifi:** Në të njëjtën lidhje, por nuk është...

**Znj. I. Nano:** E vendosim skedar dhe pas këtij momenti që pasi ju ta zhvilloni dhe të bëni testin. Pastaj të bëni edukimin, shpjegimet.

**Znj. J. Josifi:** Po pra, do kemi komunikim publik gjithsesi për këtë, sepse duhet ta përcjellim si risi që është dhe kjo mundësia e re, që bëhet kështu ose ashtu. Gjithsesi do ta bëjmë këtë... Shpresojmë që të mos ketë keqkuptime.

**Znj. I. Nano:** Atëherë riformulojmë pikën 1/2 dhe në varësi të votimit... Do të rilexohet nga zonja Vukaj propozimi i riformuluar, në eventualitetin që e miratojmë me këtë formulim, do të duhet po njëlloj të aplikohet edhe në pikën 1/1. Zonja Vukaj, ju lutem! 1/1 Kjo është 1/2 që po bëjmë tani.

**Znj. H. Vukaj:** 1/1 e kalove dhe nuk ka lidhje kjo me atë, sepse aty kërkohet të ngarkosh certifikata. Ndërsa aty ti kërkon deklaratën. Mos i konfondoni gjërat tani.

**Znj. I. Nano:** Nuk po konfondoj asnjë gjë. Edhe në pikën 1/1 që sapo votuam kemi deklaratë. Deklaratën dhe aty e ke bashkë me dokumentin e identifikimit. Edhe aty nëse nuk i bëjmë në një dokument të vetëm përftojmë të paktën tre dokumenta për të ngarkuar.

**Znj. H. Vukaj:** Pra, nëse ju e keni sa për riformulimin e fundit që ne e zgjidhëm për të lehtësuar anën teknike është gjë tjetër.

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Znj. I. Nano:** Për anën teknike po them!

**Znj. H. Vukaj:** Pikërisht pra, dakord.

**Znj. I. Nano:** Prandaj e dëgjojmë propozimin tuaj këtu, votojmë dhe mund të kalojmë edhe një herë dhe pse kemi votuar 1/1.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, në përshtatje edhe të teknikalitetit, pra për të kufizuar implikime të mundshme apo rëndesa të mundshme të platformës PER, pasi diskutuam edhe me teknikienët, kam vendosur të sjell këtë riformulim. “Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER dhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të cilit, është ky dokument. Në këtë rast personi në emër të të cilit rezulton dokumenti i adresës, duhet të lëshoj një deklaratë sipas së cilës deklaron se aplikuesi është banues në të njëjten adresë me të. Aplikuesi ngarkon në sistem këtë deklaratë të nënshkruar prej mbartësit të adresës bashkë me dokumentin e identifikimit të personit në emër të të cilit është dokumenti i adresës. Teksti i deklaratës miratohet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe vendoset në PER si tekst i detyrueshëm, të cilit duhet t’i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë dhe nënshkruhet prej tij. Në të njëjtën fletë vendoset edhe dokumenti i identifikimit i deklaruesit dhe ngarkohet në PER si një dokument i vetëm”. Besoj që nga ana teknike kjo është e zgjidhur tani.

**Znj. I. Nano:** Po, meqenëse kjo fjalia këtu, që ta kemi njëlloj, “Aplikuesi ngarkon në sistem deklaratën e nënshkruar nga mbartësi i tij..., e kemi këtu poshtë. Pra lëshon një deklaratë sipas së cilës deklaron “se aplikuesi është banues në të njëjtën adresë me të. Teksti i deklaratës miratohet me vendim të KSHZ..” dhe vijon siç e

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

propozuat ju. Pra, kjo këtu është përsëritje. Shiheni dhe me atë që kemi miratuar më sipër.

**Znj. H. Vukaj:** Po ja një minutë kohë për të vështruar, që të mos biem në përsëritje. Atëherë në kontekstin e të qenit e unifikuar kjo shtesë apo ky propozim apo riformulim me sa më sipër ne miratuam, meqenëse bie në përsëritje fjalia e cila në parim ndante se çfarë duhet të bëj aplikuesi, me fjalinë e fundit. Atëherë mendoj që të sjell dhe njëherë rileximin. “Dokumenti i adresës në emër të një personi mund të ngarkohet në PER edhe nga persona të tjerë të cilët banojnë në të njëjtën adresë me personin në emër të të cilit është ky dokument. Në këtë rast personi në emër të të cilit rezulton dokumenti adresës duhet të lëshojë një deklaratë, sipas së cilës deklaron që aplikuesi është banues në të njëjten adresë me të..”. Vijon teksti i deklaratës “... miratohet me vendim të KSHZ-së dhe vendoset në PER teksti i detyrueshëm të cilit duhet t’i përmbahet deklaruesi. Teksti i deklaratës shkruhet nga deklaruesi në një fletë të bardhë dhe nënshkruhet prej tij. Në të njëjtën fletë vendoset edhe dokumenti i identifikimit i deklaruesit dhe ngarkohet në PER si një dokument i vetëm”. Pra, kjo është në kontekstin e plotësimeve të nevojës së administratës dhe anës teknike për ta lehtësuar platformën. Deklaruesi do të marrë dokumentin e tij të identifikimit, do ta vendosë tek e njejta fletë e cila e supozojmë se këtu ka pjesën e deklaramit të nënshkrimit dhe këtu do të vendoset dokumenti i identifikimit dhe ose do të skanohet ose do t’i bëhet foto, e më pas do të ngarkohet në PER. Kjo është për të lehtësuar dhe duhet në të njëjten kohë të përshtatet edhe teksti që do të miratojë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**Zj.I.Nano:** Dakord! Kalojmë në votimin e pikës 1/2 të Kreut II.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



**Kundër:** s'ka!

**Miratohet me 5 vota pro!**

Atëherë kjo pika 2 këtu bie, nuk kemi as për ta votuar, as për ta lexuar se është çështje rirenditje. Pika që thotë, 3-shi më mirë.

Atëherë vazhdojmë me romake 2.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Para kësaj do t'iu lutesha 2-sh me romake.

II. Ngarkohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi. Mundësisht mbani tamplate për vendimet e Rregullatorit. Votojmë këtë kolegë.

**Znj. H. Vukaj:** Me shume të drejtë ju e ngritët këtë zonja Nano dhe tashmë ky tamplate është krijuar edhe pse automatikisht këtu Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve i lind detyrë e menjëherë dhe parësore që të miratojë menjëherë tamplaten dhe teksin, por në suazën e tërësisë së KQZ-së, aty bën pjesë dhe KSHZ-ja, që kështu është pjesë e ezauruar dhe gjithpërfshirëse.

**Znj. I. Nano:** Atëherë 2-sh me romake, Ambra të lutem!

II. Ngarkohet Komisionit Qendror i Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s'ka!

**Miratohet me 5 vota pro!**

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** s'ka!

***Miratohet me 5 vota pro!***

IV. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s'ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe një herë kolegë dakordësinë tuaj në lidhje me projektvendimin duke pasur parasysh edhe të gjitha ndryshimet e pësuar.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)***

***Kundër: s'ka!***

***Miratohet me 5 vota pro!***

Do të ftoja kolegët të bënim 10 minuta pushim. Më tej vazhdojmë me çështjen në rendin e ditës, por të mbartur nga mbledhjet e kaluara.

**Vendimi nr. 8**

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

13.02.2025  
Ora 17:12

**RENDI I DITËS**

**Projektvendimi: “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”.**

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ P. Doçaj, A. Agolli**

**Parti Politike: PD (F. Nuri)**

**OJQ: KRIIK**

**Znj. I. Nano:** Rifillojmë mbledhjen. Mbaruam me shqyrtimin dhe miratimin e projektaktit që kishim në rendin e ditës. Kemi një projektakt të mbartur. “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Zonja Doçaj, ju lutem shkurtimisht për projektaktin.

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

*Znj. P. Doçaj:* Po faleminderit. Me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve bazuar në nenin 20, pika 1, shkronja “c” e Kodit Zgjedhor, për kompetencë, ju është paraqitur për shqyrtim projektvendimi “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Në vlerësim të Komisionerit miratimi i këtij akti vjen si nevojë e përmirësimit e të gjithë kuadrit rregullator në fuqi në lidhje me sjelljet dhe veprimtaritë e institucioneve publike në periudhën 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në krijim të qeverisë së re pas zgjedhjeve. Nevoja për përmirësim të këtij kuadri rregullator bazohet edhe në reflektim lidhur me praktikën e krijuar deri tani në zbatim të këtij vendimi pra, vendimit nr. 9/2020. Komisioneri vlerëson se nëpërmjet këtij akti dhe bazuar edhe në nenin 91, të Kodit Zgjedhor ka përmirësim, qartësim dhe është më e zaurues në lidhje me atë ç’ka ndalohet apo jo, për të gjitha institucionet publike në periudhën e sipërcituar. Akti është i hartuar në tre krerë. Në kreun e parë përcaktohen qëllimet, përkufizimet dhe rregullat e përgjithshëm. Në kreun e dytë parashikohen kategoritë e ndalimeve dhe në kreun e tretë përcaktohen dispozitat e fundit. Po kështu përcaktohen edhe subjektet që duhet të zbatojnë këtë vendim që janë institucionet publike dhe administrata shtetërore, po kështu dhe terminologjia se çfarë është përkufizimi më saktë i veprimtarisë publike, veprimtaritë e ndaluara, cilat janë asetet publike etj. Miratimi i këtij akti ndan një akt tjetër rregullator. Pra, për këte do të ishte dhe me rëndësi çështjen e raportimit të veprimtarive publike të institucionit në ndërfaqe dhe të gjithë pjesën tjetër të rregullimit të veprimtarive të ndaluara dhe ato publike. Duke qenë se ashtu sikundër u la dhe detyrë në seancën e shkuar, ne kemi integruar në aktin përfundimtar të paraqitur përpara jush, propozimet e dy anëtarëve të Komisionit Rregullator që kanë të bëjnë me kreun 1, pika 1.2 me veprimtaritë publike. Pra e kemi ridemisionuar këtë përkufizim duke shtuar edhe propozimet e anëtarëve të Komisionit Rregullator.

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

Kemi integruar në këtë akt në kreun 2 pika 2.2, gërma 2 kemi shtuar veprimtari të ndaluara për t'u promovuar dhe kemi integruar në kreun 2, pika 2.4 , pikën 6, 7 dhe 8 që ka të bëjë me kategorinë e punonjësve të administratës. Pra, ndalimet dhe sjelljet e administratës shtetërore. Nisur nga sa më sipër, i kërkojmë ose sjellim propozim për shqyrtimin tuaj projektvendimin “Për rregullat e sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje dhe ndalimin e keqpërdorimit të aseteve publike”. Kjo në mënyrë pak të përmbledhur në fakt. Bashkëlidhur keni dhe projektvendimin përkatës.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Doçaj. Fillojmë shqyrtimin në parim. Kush e do fjalën? Zoti Çakaj?

**Z. M. Çakaj:** Po faleminderit zonja kryetare. Unë e dëgjova me vemendje relativisht. Kemi parë dhe aktin që ka përgatitur Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Duhet të theksojmë faktin se ky akt i propozuar për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator është në vlerësim tim, por besoj dhe të koleges zonjës Vukaj, është një hap përpara, në raport me ndryshimet dhe në raport me adresimin e të gjithë problematikave të evidentuara deri tani, lidhur me sjelljen e institucioneve shtetërore përpara fushatës zgjedhore. Pra, periudhën 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve si dhe në periudhën 30 ditë gjatë fushatës zgjedhore. Megjithatë, duhet të theksojmë faktin që ky akt dhe këtu, sigurisht që gjatë shqyrtimit nen për nen do të kemi edhe propozime konkrete, nuk adreson të gjitha problematikat të lindura, të konstatuara të cilat kanë nevojë për një adresim më të saktë. Kanë nevojë për formulime në këtë akt dhe nuk duhet të ndalemi te formulimet, por do të duhet që nëse, do t'iu ftoja me sinqeritet gjithë kolegët e këtij komisioni ta votojmë, ta miratojmë këtë akt. Nëse ne do të biem dakord këtu, është shumë e nevojshme që implementimi i këtij akti në praktikë të jetë ekzaktësisht siç e kemi miratuar. Një risi dhe një nevojë e shtuar për

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

ndryshime në vendimin nr. 9 është edhe përfshirja për herë të parë në procesin e votimit të shtetasve shqipëtarë me banim jashtë vendit. Në këto kushte, nisur edhe nga situata aktuale ku po konstatojmë që burimet shtetërore po keqpërdoren në mënyrën më të paskurpullt të mundshme nga institucionet qoftë vendore, qoftë qendrore të cilat janë në pushtet. Unë mendoj që së pari, duhet të fillojmë.., pra ajo ç'ka i mungon këtij akti është implementimi i parimeve të paktën një ose dy parime. Parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për mos keqpërdorim, për të ruajtur nga keqpërdorimi të burimeve shtetërore, si dhe parimi i kontrollit. Të paktën këto dy parime do të duhet t'i shtohen këtij akti. Krahas kësaj kur të vijë momenti konkret që do shqyrtojmë nen për nen, një rëndësi të veçantë duhet të marrë në këtë akt edhe përfshirja e një propozimi e cila ka të bëjë me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Është shumë e rëndësishme që Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit e Republikës së Shqipërisë edhe nëse qeveria shqiptare, edhe nëse një institucion tjetër vendor apo i varur nga qeveria shqipëtare ka miratuar një akt është shumë e rëndësishme.., që ka miratuar një akt që presumohet ose presupozon që të prodhojë efekte pozitive elektorale për një forcë të caktuar, atëherë do të ishte e nevojshme që të kishim një element garancie. Pra, Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit do të duhet të pezullojë të gjitha pagesat, të cilat kanë efekt financiar nga periudha 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve. Edhe nëse aktet janë miratuar përtej kësaj periudhe. Sepse çfarë ka ndodhur? Edhe në relacionin e projektaktit të cilin jua kemi propozuar, është rrëzuar në parim nga ju të nderuar kolegë, por disa dispozita janë ripërfshirë këtu për t'u diskutuar, ne kemi evidentuar në mënyrë të qartë me prova, me fakte se çfarë ka ndodhur. Ka ndodhur që është përdorur një truk ligjor elektorale nga qeveria shqiptare. Pra, miratohet akti i cili synon të jap favorizime për disa kategori të caktuara, në ndalim të normës së përcaktuar të nenit 91, të Kodit Zgjedhor. Miratohet në disa raste edhe disa orë para datës së periudhës së ndaluar,

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

por edhe disa ditë, apo javë dhe efektin e ka ekzaktësisht brenda periudhës 4 mujore. Atëhere kjo është totalisht e ndaluar. Kjo nuk mund të funksionojë kështu. Pikërisht ne do të duhet ta normojmë këtë veprimtari, në mënyrë që palët të shkojnë në zgjedhje me armë të barabarta, me sigurinë juridike që të dy do të jenë përballë votuesit të barabartë. Kështu që, ju ftoj ta shqyrtoni me objektivitet dhe sigurisht ta miratojmë këtë projektakt. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zoti Çakaj! Zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Pasi dëgjova relatimin e zonjës Doçaj prisja që në këtë vendim integral minimalisht të justifikohet koha e mbatjes dhe afati një mujor i pasivitetit dhe i dekadencës së tij. Ne në mënyrë konstruktive dhe të nxitur pozitivisht për t'i shërbyer këtij procesi dhe për ta bërë atë të barabartë për palët, bashkë me kolegun Çakaj propozuam në dy mbledhje më herët propozime konkrete të cilat me të vërtetë i shërbenin interesit publik dhe legjitimitetit të zgjedhjeve të pandikuara. Nga relatimi kuptova dhe njëkohësisht dhe nga drafti që na është paraqitur përpara, që as 1/3 e propozimeve tona nuk është marrë në konsideratatë. Ato që janë marrë në konsideratë janë thjesht një garniturë, që ndoshta edhe mund të quhen larje goje që “shiko se mora në konsideratë disa, por të tjerat nuk i konsideroj”. Natyrshëm mua më lind pyetja, kush ka qenë etaloni? A keni përdorur ndonjë referencë nga jurisprudenca? A nga doktrina që disa i keni pranuar disa nuk i keni pranuar. Ose keni mbajtur disa përkufizimet tuaja që ndoshta në mënyrë të njëanshme dhe subjektive ju duken ju më të mira, por që vërtet nuk i shërbejnë procesit. Unë jam parimisht partizane e kalimit të përmirësimeve në këtë akt. Gjithashtu në të njëjtën kohë jam dakord që ky akt edhe mund të ndahet për lehtësi procedimore. Nga ana tjetër nuk gjej..., për sa kohë nuk gjej në mënyrën se si është sjellë një akt i veçuar,

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

ai që rregullon kategoritë e veprimtarive të ndaluara, nuk ka konstruktivitetin, ose nuk ka formatimin e aktit tjetër që presupozohet të ndahet, atë raportimit të veprimtarive të ndaluara, kjo e bën pak të pastandard ruajtjen e disa elementëve teknikë dhe të teknikës legjilative. Pra, një akt nuk mund të ndërtohet pa parime, për më tepër që vetë administrata dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, për këto zgjedhje nën suazën edhe të paketës që ne kemi miratuar për përfshirjen e kategorisë së emigrantëve si votues për herë të parë në këto zgjedhje, ka sjellë çdo akt mbi bazën e parimeve. Natyrshëm sërish lind pyetja, si mundet një akt të ndërtohet pa parime? Të ndërtohet minimalisht pa përkufizimin se çdo të thotë veprimtari publike dhe më pas veprimtari e ndaluar dhe më pas nuk pash aty as edhe disa elementë të tjerë, të cilët janë aplikuar më herët, të miratuar me vendimin 473 të 2017. Pra, janë praktikuar dhe për to ka pas vullnet nga Këshilli i Ministrave i po kësaj force politike që ka qenë në krye të vendit edhe në vitin 2017. Si psh pika 5, e cila parashikonte “Gjatë pjesëmarrjen në veprimari politike apo zgjedhore nëpunësit civil ndalohet të shpreh publikisht bindjet apo preferencat e tij politike dhe të bëjë fushatë për një subjekt zgjedhor apo kandidat. Gjithashtu i ndalohet të manifestojë me pankarta, parrulla, apo çdo mjet tjetër të shkruar e të ekspozuar publikisht. I ndalohet të jetë protagonist në aktivitetet dhe veprimtaritë politike”. Kjo do t’i shërbente dhe do të ishte një mbrojtje shumë e mirë, një korac shumë e mirë për administratën dhe nëpunësit e saj, të cilët të detyruar për të mbajtur vendin e punës sot dhe obligohen dhe nxiten me “dhunë” që të dalin të përkrahin, të jenë aktivë në të gjitha mjetet dhe format për të avantazhuar një forcë politike. Pra, vonesa e para, e pajustificuar e mbajtjes kaq gjatë për një muaj, pa një akt. E dyta, mospërfshirja vërtet me një lloj qasje konstruktive e propozimeve tona, përmbajtjen e këtij akti, sinqerisht, e bën të pakonsoliduar ose të pamjaftuar për të qenë një akt i pavarur, i veçuar nga ai i raportimit të veprimtarive të ndaluara dhe në të njëjtën kohë nuk e bën me të mirë se

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

vetë vendimi 9, i cili nuk kërkon gjë tjetër veçse kërkon vullnet të nderuar, për ta zbatuar. Pra, ne ndodhemi këtu sot, për hir të justifikimit i atij vullnetit të munguar për ta aplikuar siç duhet atë vendim. Ndërkohë që këto janë zgjedhjet e treta, nuk po i llogaris zgjedhjet e pjeshme e sporadike që janë bërë, por zgjedhjet e treta në shkallë vendi, të cilat dëshmonin se kërkohej ndërhyrje jo për hir të mungesës, për të justifikuar vullnetin e paaplikuar, ose të cunguar. Por për t'iu përshtatur nevojës dhe domosdoshmërisë për të parandaluar dhe ndaluar tashmë atë abuzimin masiv që po bëhet me administratën, ose përdorimin e “armëve” avantazhuese që ka njëra forcë politike në raport me forcat e tjera politike. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit zonja Vukaj. Kemi diskutime të tjera në parim? Kalojmë në votimin në parim të projekvendimit.

Kolegë, kush është dakord?

**Kolegë, kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)**

**Kundër: s'ka!**

**Miratohet me 5 vota pro!**

Fillojmë me shqyrtimin e përmbajtjes. Sikundër jeni në dijeni është një tekst që ju është vënë në dispozicion. Nuk ju është vënë në dispozicion shoqëria civile?

Mund të kemi një kopje ju lutem! Mqs kemi një përfaqësues nga shoqëria civile.

Që të mos lexojmë gjithë tekstin e të vlerësojmë ndërhyrjet e secilit prej nesh gjatë diskutimit nen për nen. Atëherë me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Komisioni Rregullator vendosi:

Kreu I. Qëllimi dhe përkufizimet e rregullat e përgjithshme.

Kemi qëllimin, kemi disa përkufizime, në fakt këtu janë 11 të tilla, por në pikën 3 “institucion publik” është përmendur dy herë, pra dhe 1-shi dhe 3-shi. Koncepti

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

“veprimtari publike” duhet të marrë numër. Koncepti “veprimtari e ndaluar” duhet të marrë numër dhe pastaj të miratohet. Më tej kemi rregulla të përgjithshme. Tani kolegë, dëshironi ta lexojmë të gjithë?

**Z. M. Çakaj:** Jo, ne jemi njohur, por unë kisha propozim për këtë.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Atëherë nuk po e lexojmë tekstin. Teksti është publik në faqen tonë të internetit, është bërë publik. Ju është dërguar partive politike dhe shoqërisë civile, ju lutem një kopje siç ja vendosët në dispozicion të printuar. Dërgojeni dhe me email. Atëherë filloni me shqyrtimin, nëse ka propozime i marrim me radhë. Te qëllimi, po zoti Çakaj!

**Z. M. Çakaj:** Po, faleminderit e nderuar. Pas pikës 1.1 te qëllimi, të shtohet pika 1.2 dhe të tjerat të spostohen më pas, me këtë përmbajtje me titullin “Parime të përgjithshme” dhe këtu të vendosim, të përfshihet parimi ligjshmërisë, parimi i transparencës dhe i informimit, parimi i drejtësisë, i paanësisë dhe objektivitetit, parimi i sigurisë dhe përgjegjësisë për moskeqpërdorim të veprimtarive të ndaluara dhe parimi i kontrollit. Atëhere, këtu po të doni, e propozojmë formulimin konkret të parimeve, por të biem dakord në parim njëherë, nëse e pranoni këtë propozim dhe këtu...

**Znj. I. Nano:** Do të votohet çdo propozim. Ju po thoni parimet duke i përmenduar apo parimet duke i sqaruar?

**Z. M. Çakaj:** Parimet duke i përmenduar dhe sigurisht edhe duke i formuluar. Duke qenë se kemi të bëjmë...

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

**Znj. I. Nano:** Duhet ta lexoni propozimin.

**Z. M. Çakaj:** Nuk ka problem, biem dakord për këtë. Të sqaroj dhe diçka, në parimin e ligjshërisë biem dakord të gjithë së bashku, që të përfshihet nëse ju, sigurisht unë me kolegen jemi dakord, e kemi diskutuar ka qenë dhe propozimi i hershëm i joni, që këtu të përfshihet së pari, koncepti i veprimtarive të ndaluara. Veprimtaritë e ndaluara nga institucionet shtetërore apo zyrtarët publikë kryehen si brenda dhe jashtë vendit. Rastet konkrete të cilat i kemi parë masivisht, janë publike, i kemi parë ne media i shohim dita-ditës raste konkrete. Rezulton që kemi denoncim dita-ditës për veprimtari publike të ndaluara, keqpërdorim të burimeve publike jashtë vendit. Pra, nëse pranohet ky koncept, e materializojmë dhe sigurisht që e lexoj dhe propozimin konkret për parimin. Do të dëshiroja që të kemi një qasje dhe një orientim lidhur me këto parime që u përmendën. Pra, nëse ju jeni dakord, atëherë patjetër i propozojmë dhe i shtjellojmë. Kështu që do të doja ta hidhnim në propozim njëherë këtë si koncept.

**Zj. I. Nano:** Tani për sa thatë te përkufizimet “veprimtari publike” është ai shqetësimi juaj i pasqyruar, në tekstin që na është propozuar. Në qoftë se parimet janë ato që kishit në propozimin e kaluar, personalisht vlerësoj që ato parime lidhen me raportimin me tepër se sa me..

**Z. M. Çakaj:** Po dakord, por të paktën dy nga ato parime lidhen edhe me veprimtaritë e ndaluara.

**Znj. H. Vukaj:** Sa për saktësi veprimtari publike këtu është mbartur nga vendimi 9 dhe thuhet “... janë të gjitha veprimtari dhe aktivitete që janë të hapura”. Ndërkohë

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt. 13.02.2025*

që ne sjellim “Të gjitha veprimtaritë me karakter publik e të përgjithshëm të zhvilluar brenda dhe jashtë vendit, të cilat duhet të ushtrohen pa ndikim, pa cënuar objektivitetin e përfitimit publik, e pa qëllime të caktuara politike, favorizuese...”, e kështu me rradhë. Pra, nuk është e njëjta gjë.

**Znj. I. Nano:** Atëherë do kalojmë te votimi i “qëllimit” njëherë dhe pastaj te parimet. Sipas rradhës...

**Z. M. Çakaj:** Si të doni. Me qëllimin në jemi dakord, problemi është se...

**Znj. I. Nano:** Po pra, do ta hedhin në votë, t'i marrim nënkrerët me rradhë, për të mos i marrë pikë për pikë. Ku ka vend, mund të ndërhyjmë dhe në çdo pikë nënkreu. Këtu kemi dy pika të qëllimi.

*Zbardhi materialin audio  
Areta DULAKU*



**Znj. I. Nano:** Kemi diçka për 1.1 qëllimi apo të kalojmë në votimin...

**Z. M. Çakaj:** Atëhere, kemi edhe një propozim tek qëllimi, po e formuloj. Atëherë, “qëllimi i këtij vendimi është marrja e masave, monitorimi dhe parandalimi i veprimtarisë, sjelljes apo përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike, të institucioneve qendrore dhe vendore si dhe administratës shtetërore brenda dhe jashtë vendit gjatë periudhës 4 muaj para datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve si dhe gjatë fushatës zgjedhore me qëllim nxitjen e pa anëshmërisë dhe të trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe partive politike për krijimin e kushteve të drejta dhe të barabarta për të gjithë kandidatët dhe partitë politike që marrin pjesë në procesin zgjedhor si për mos përdorimin e fondeve dhe burimeve publike për qëllime partiake. Subjekte të këtij vendi janë institucionet publike dhe administrata shtetërore sipas përkufizimeve në këtë vendim”. Pra, pika e dytë është ekzaktësisht siç ishte, pika një është përfshirja “brenda” dhe “jashtë vendit”.

**Znj. I. Nano:** Në rregull, kalojmë në votimin e propozimit të kolegut Çakaj, lidhur me ndryshimet në pikën 1 të nën kreut 1.1 të kreut 1 qëllimi.

***Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?***

**Pro:** 3 (znj.Nano, znj. H. Vukaj, z.M. Çakaj)

**Kundër:** 2 (z.A. Çela, z. D. Çaka)

Nuk miratohet!

Kalojmë në votimin e propozimit të ardhur zyrtarisht.

***Kush është dakord me propozimin?***

**Pro:** 2 (z.A. Çela, z. D. Çaka)

**Kundër:** 3 (znj.Nano, znj. H. Vukaj, z.M. Çakaj)

Nuk miratohet!




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.13.02.2025*

**Z. M. Çakaj:** Të biem dakord për diçka, në kushtet kur, domethënë edhe për ekonomi të kohës së gjithsecilit prej nesh. Në kushtet kur në parim jemi dakord që ndryshoi vendimi nr. 9 por nuk biem dakord për qëllimin e këtij akti. Nuk biem dakord sigurisht edhe për parimet, unë mendoj që diskutimet e mëtejshme janë pa vlerë për sa kohë ne kemi koncepte diametralisht, tre prej nesh kanë koncepte të ndryshme lidhur me qëllimin e miratimit të rregullave të sjelljes së institucioneve publike në zgjedhje, ndalimin e keqpërdorimit të asetëve publike. Çfarë do të thotë kjo?! Kjo do të thotë se për sa kohë institucionet publike duhet të sillen në një mënyrë të caktuar, asetet publike do të duhen të përdoren në një mënyrë të caktuar. Pra, nuk do të duhet që të keqpërdoren biem dakord për diçka asetet publike nuk janë të titullarëve. Institucionet publike nuk janë në pronësi të titullarëve, institucionet publike janë të të gjithëve ne, janë të të gjithë popullit shqiptarë, janë të të gjithë taksa paguesve, janë të gjithë shqiptarëve me banim brenda dhe jashtë vendit dhe nuk mund të miratojmë rregulla sjellje ne vetëm për brenda vendit. Ndërkohë që ne kemi parë me zë dhe me figurë, gjysma e administratës, gjysma e qeverisë, disa nga kryebashkiakët bashkë me stafin e tyre ndodhen në Greqi për procesin e regjistrimit madje duke marrë edhe atributet e KQZ-së duke u prezantuar si zyrtarë të KQZ-së, ka sjellje më të gabuar se kjo ka veprimtari më të ndaluar se kjo. Ka keq përdorim më të madh të fondeve publike se kjo. Pra, qeveritarët shqiptarë apo kryetarët e bashkive apo nën punësit civil të bashkive janë zgjedhur në atë detyrë për ti shërbyer qytetarëve të bashkisë përkatëse apo qytetarëve të shqipërisë në rastet e qeveristarëve nuk janë zgjedhur vetëm për qëllime elektorale. Ne e kemi kthyer Shqipërinë puno për të vjedhur, jeto për të vjedhur dhe mekanizmi që synon për të bërë të gjithë këtë është vota edhe votën po e vjedhin. Gjithëçka e kanë venë në funksion të qëllimit të tyre, sigurisht të pa ligjshëm, kështu që në gjykimin dhe kënvështrimin tim nuk ka se si mund ta vazhdojmë votimin nëse nuk biem dakord me qëllimin e këtij akti. Pra, për rregullimin e sjelljes së institucioneve

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



publike brenda dhe jashtë vendit. Që këtu ne jemi ndarë në mënyrë diametralisht të kundërt për normat e sjelljes, për mënyrën, qëllimin se çfarë, se si duhet të sillet një institucion qendror apo vendor në raport me asetet publike që nuk janë të tijat personale, nuk ia ka lënë as nëna, as babai, janë tonat të gjitha. Ai thjesht është ushtruesi i detyrës, është i mandatuar, është i zgjedhur, për të ushtruar atë detyrë, nuk i ka të xhepit të vet. Edhe po ti kishte të xhepit të vet të gjitha ato, ka norma të tjera të cilat i rregullojnë se si mund ta financosh një fushatë sa mund të përdorësh si mund të përdorësh. Kështu që për mua nuk ka kuptim më vazhdimi.

**Z. I. Nano:** Kolegë për procedurë, qoftë edhe pa i lexuar sepse kemi hyrë në shqyrtimin nen për nen ose kre për kre. Mua do të më duhet të bie dakord me arsyetimin tuaj në qoftë se bie qëllimi i një norme, pjesa tjetër pastaj nuk ka rëndësi por për procedurë. Kemi kreun e parë, po votojmë propozimin e ardhur zyrtarisht.

***Kush është dakord me kreun e parë?***

***Pro:*** 1 (zgj. I. Nano)

***Kundër:*** 4 (z. A. Çela, z. D. Çaka, zgj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Nuk miratohet!

Kreu i dytë kategoritë e ndalimeve. Përpara se të kaloj në votim dëshiroj të jap edhe unë mendimin tim për diçka që në qoftë se do ta shqyrtonim me diskutime nen për nen. Unë në çdo rast do të votoja kundër kreut 2.2 përveç pikës 2 që është propozuar nga kolegët për shkak se e mendoj kështu siç është formuluar mendoj që bie në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Kur flitet për ndalime, për promovimin e veprimtarive publike. Janë të ndaluara veprimtaritë publike me karakter politik të institucioneve publike por vazhdon promovim, promovim etj, etj. Në fakt e nxitur edhe nga një rekomandim i organizatës KRIIK mu desh ta shoh në mënyrë tërësore Kodin Zgjedhor edhe njëherë lidhur me këtë çështje,

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.13.02.2025*

mendoj që ky bie në kundërshtim me nenin 81 pika 3. Ky propozim kështu siç ka ardhur nga organizata KRIIK me të drejtë kërkoi që të saktësonim me se çfarë kuptonim me veprimtari me karakter politik dhe referenca më e mirë ishte pikërisht në nenin 81 pika 3, që në fakt lidhet me edicionet informative të Radio Televizionit Publik ku parashikohet transmetimi i veprimtarive të institucioneve publike qendrore ose vendore, llogaritet në kohën e transmetimit të subjektit zgjedhor të cilit i përket titullari i institucionit nëse veprimtaria ndjek qëllime elektorale. Veprimtaria ndjek qëllime elektorale kur ajo synon promovimin e arritjeve institucionale, të investimeve, të inagurimeve ose ecurinë në ndërtimin e punëve publike ose kur promovon aspekte specifike të programit elektorale të subjektit zgjedhor. Porë në këtë këndvështrim interpretimin që i bëj unë nenit 81 dhe veçanërisht pikës 3, lidhen me faktin që këto lloj veprimtarish jo vetëm që nuk janë të ndaluara, janë të lejuara, janë dhe të rregulluara, janë dhe të rregulluara në kuptim të normimit të transmetimit në televizionin publik pra të minutazhit. Thënë me fjale të tjera ato i llogariten në kohë subjektit zgjedhor të cilit i përket titullari i institucionit. Pra, nëse do të vinim me detaje, këtë që sapo thashë do ta diskutoja. Po kolegë!

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Shiko unë jam 100% kundra me atë që ju deklaruat për arsye se bashkë me kolegun Çaka kemi pasur fatin të jemi edhe në grupin e punës për hartimin e Kodit Zgjedhor dhe u bënë si u bënë ndryshimet sepse gjysma e politikës nuk ishte në Kuvend. Në rastin më të mirë është përplasja me dispozitën e nenit 91 kjo. Po qëllimi i posaçëm i ligjvënësit neni 91 dhe neni 92 për të ndaluar promovimin për të marrë avantazhe elektorale, ligjvënësi e ka parashikuar nenet 91-92. Pra, sjelljet neni 91 ndalimi i përdorimit publik të burimeve publike mbështesin subjektet zgjedhore dhe neni 92 veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë. Tani në vendimin nr.9 sigurisht ka edhe gjëra që sjanë kuptuar mirë por unë mendoj se kemi bërë një punë të mirë. Ka nevojë

*Zbardhi materialin audio  
Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.13.02.2025*

për përmirësim? Gjithmonë, por implementimi del. Promovimi duhet të jetë si detyrë funksionale e çdo institucioni, promovimit kur i bën publicitet dhe këtu kalojmë tek propozimi që bëri kolegja Vukaj për të bërë një përkufizim të qartë se çfarë do të thotë veprimtari publike. Promovimi me publicitet do të thotë avantazh i pa drejtë elektoral, ti nuk je zgjedhur aty për të treguar ja si qysh tek. Ti ke për të bërë detyrën tende funksionari të institucionit nuk mund të marri avantazhe të pa drejta dhe sa për dijeni ato çfarë ka bërë ka qenë programi elektoral i para katër vjetëve. Nuk është programi elektoral çfarë propozon ky dhe në gjykimin tim palët garuese duhet të garantojnë dhe duhet të garojnë me programe elektorale, pra çfarë i propozojnë ato, çfarë do të bëjnë ato për qytetarët, për zgjedhësit, dhe në këtë mënyrë do të fitojmë besimin e tyre për ti dhënë votën ose jo. Nuk mund të mburren palët elektorale dhe nuk mund të përfitojnë avantazhe të pa drejta kush është në pushtet se me këtë teori i bie që nuk ka kurrë rrotacion dhe kjo po ndodh në Shqipëri. Nuk ka, e di pse nuk ka? Se nuk ka votë të lirë të ndershme edhe për faj të keq përdorimit të burimeve publike edhe për faj të shantazhit që iu bë punonjësve të administratës apo edhe për faj të blerjes me pensione që iu bëhet në prag fushate. Për mua këto janë veprimtari jo vetëm të ndaluara por edhe të paligjshme meritojnë edhe të ndiqen penalisht. Kështu që pikërisht për këto arsye unë nuk jam dakord me gjykimin tuaj dhe sigurisht mbaj gjykimin tim dhe jam kundra këtij propozimi konkret.

**Znj. I. Nano:** Në fakt nuk bëra asnjë propozim, bëra një koment. Zoti Çakaj!

**Z. D. Çaka:** Faleminderit! Në kushtet kur edhe pjesa e votimit po bëhet po themi me krerë do të doja që edhe për atë që ne kaluam në votim, kreu I por edhe për pjesën e kreut II dhe për pjesën tjetër të aktit do të doja, që të shprehja faktin që duke qenë se u votua kreu I komplet në bllok dhe të paktën unë e votova kundër, do të doja të kisha një shpjegim të asaj vote. Jo i gjithë kreu

*Zbardi materialin audio  
Ardita ÇAMI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.13.02.2025*

është në kundërshtim me vlerësimin dhe mendimin tim. Por në vlerësim dhe në mendimin tim mendoj që akti nr. 9 është i normuar mirë kur ka përcaktuar kompetencën e këtij akti brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Kjo lidhet me argumentin që edhe tek kreu 1, tek pika 1.1 apo tek kreu 1 tek veprimtaritë publike, po e kaloj edhe tek kreu 2, tek pika 1.2 tek pika 2 pra, po argumentojë pjesën e votës time të këtyre pjesëve. Pra, diferencën në mendim që kemi në kolegët edhe nëse do të jetë edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë apo vetëm brenda. Unë jam që të jetë vetëm brenda ashtu siç është e normuar. Jam pjesërisht dakord edhe me pjesën e diskutimit të kolegut Çakaj që thotë që më e rëndësishme është që të votohemi për ato se çfarë ne do të bëjmë për katër vite si qeveri sepse është më e rëndësishme ajo sepse për 4 vite e merr qeveria votën. Por dua të theksoj edhe një gjë që asnjëherë nuk mundet që të shihen gjërat e prera dhe puna që mund të ketë bërë edhe një qeveri edhe më përpara është e rëndësishme. Sepse në qoftë se do të ngelemi në nivelin thjesht të një programi, atëherë çfarë do të ndodhte nëse një parti politike jashtë po themi dy partive kryesore e marrin gjithmonë pushtetin do të bënte një program futuristik dhe nuk do ishte shumë i realizueshëm atëherë do votohesh gjithmonë nën... Por prandaj doja ta merrja fjalën për të bërë një diferencë dhe jam dakord me atë çfarë zoti Çakaj tha, që duhen parë gjërat për t'i ndarë që në konceptin e diskutimit. Pra, me të drejtët ai bëri një propozim që bashkë me kolegen Vukaj për ta përcaktuar shtrirjen e territorit të funksionit të këtij akti edhe jashtë, ndërkohë ne këtu ndahemi edhe kjo pjesa në të cilën unë tek akti nuk jam dakord, ndërsa për pjesët e tjera nuk është se kishim kundërshtime.

**Znj. I. Nano:** Zonja Vukaj!

**Znj. H. Vukaj:** Është në të drejtën tuaj kolegë të nderuar të mos bini dakord, sepse ajo arma juaj është vota në këtë rast pro apo kundër dhe nuk ju

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.13.02.2025*

imponohemi. Por ju vetë duhet të ishit shqetësuar si për pasivitetin dhe dekadencën të mos vënies në lëvizje të këtij institucioni në raport me çfarë po ndodh sot jashtë dhe brenda vendit. Kjo është shumë shqetësuese dhe pa dyshim që ka ndikuar deri më tani në palët dhe në paraqitjen e tyre në një garë e cila duhet se sbën të ishte e barabartë, është esenciale kjo për një proces zgjedhor. Ku ashtu siç theksoj kolegu Çakaj ato duhet të mateshin me njëra tjetrën me programet e tyre dhe jo me valencat e tyre për hirë të pasjes së njëres palë pushtet dhe prej pushtetit vjen gjithë forca. Në këtë kuadër unë gjithashtu do të preferoja të dëgjoja sot nga ju që të ngrinit shqetësimin që administrata vonon edhe një javë përtej mbatjes kaq gjatë të këtij akti që u vu në lëvizje vetëm pasi panë që dy anëtarë të Komisionit Rregullator e vunë në lëvizje. U ngjiz ky akt aty për aty, ca copa u morën nga vendimi ekzistues, ca nga ndonjë gjë tjetër, dhe ca u bënë sikur u implementuan propozimet e anëtarëve. Pra, duhet të ishit në këtë shqetësim që pse kaq vonë, kujt i shërben kjo? Pa dyshim që i shërben vetëm njërit krah, domethënë nuk do ndonjë inteligjencë të ekzagjeruar apo mbi nivelin mesatar që ta kuptojë këtë. Ky ishte shqetësimi, megjithatë meqë qëllimi i këtij akti ra të kalojmë të vijojmë me procedurën sepse nuk ka më sens që ne të merremi tani në mënyrë eksplicite se çfarë mendonte njëri post apo se çfarë mendonte njëri paraprakisht.

**Z. M. Çakaj:** Edhe diçka meqë po e vazhdojmë si procedurë, do bëj propozim konkret. Atëherë në kreun 2 kategoritë e ndalimeve pika 2.1 ndalime për miratime të akteve juridike, pas pikës 1 dhe 2 të shtohet pika 3 me këtë propozim konkret. “Katër muaj përpara datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit pezullon të gjitha pagesat për shlyerjen, likuidimin pjesor, ose tërësor, të gjitha fondeve të miratuara alokuara nga qeveria apo ente tjetra shtetërore për financimin e veprimtarive të ndaluara siç përcakton neni 91 pika 4 e Kodit Zgjedhor, si dhe siç përcakohet në këtë

*Zbardhi materialin audio  
Ardita CAMI*



vendim. Pagesat do të pezullohen nga Drejtoria e Thesarit edhe nëse vendimi i qeverisë apo eneteve të tjera shtetërore është miratuar përpara periudhës 4 mujore por parashikon të japi efektin financiar brenda periudhës 4 muaj përpara datës së zgjedhjeve.

**Znj. I. Nano:** Atëherë, në kreun 2 kemi një propozim tek nën kreu 2.1 të shtohet pika 3. Kemi gjë tjetër për kreun dy? Jo. Votojmë kreun 2 me propozimin e kolegut Çakaj!

**Kush është dakord me propozimin e zotit Çakaj?**

**Pro:** 2 (znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Kundër:** 3 (znj. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka)

Nuk miratohet!

Do të duhet kreun 2 siç ka ardhur si propozim ta votojmë.

**Kush është dakord?**

**Pro:** S'ka!

**Kundër:** 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Nuk miratohet!**

Kreu 3 dispozitat e fundit. Po votojmë për procedurë se duhet të votojmë mos miratimin le të themi.

**Z. M. Çakaj:** Më lejoni edhe diçka. Se duke qenë se nuk e lexuam propozimin e ardhur të paktën të ngelet rekord për diskutim. Edhe në aktin e parë të sjellë nga Komisioneri por edhe në aktin e dytë që ka përfshirë edhe disa koncepte tona jo të tëra por disa koncepte i ka përfshirë nën kreu 2.5 kemi një propozim për rregulla të përdorimit të rrjeteve sociale dhe medias online. Këtu në thelb Komisioneri ka propozuar që të ndalohen i gjithë publikimi në rrjetet sociale të personave zyrtarë në rrjetet zyrtare. Ndërkohë që në rrjetet personale mund të bësh çtë duash. Tani unë kam një paqartësi dhe një pyetje për administratën,

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*



nëse Muharrem Çakaj anëtar i Komisionit Rregullator si mund ta ndash nëse unë nuk e bëj, unë nuk kam rrjet zyrtar, nëse unë do të kisha rrjet zyrtar, do të kisha dhe rrjet personal, dhe unë promovimin e një veprimtarie nuk e bëj atje po e bëja këtu në faqen personale. Do të përbënte, sipas propozimit tuaj nuk përbën veprimtari të ndaluar ndërkohë që në thelb unë e arrija qëllimin. Pra, nuk e bëja në faqen zyrtare por e bëja në faqen personale dhe qëllimin e veprimtarisë të cilën më jep mua avantazh elektoral të pa drejtë do ta bëja në këtë mënyrë. Pra, cili ka qenë koncepti i Komisionerit kur nuk e përfshiu faqen personale?

**Znj. P. Doçaj:** Përcaktimi i pikës 2 pika 5 “Funksionarët publikë të çdo niveli nuk mund të përdorin direkt apo indirekt llogaritë e tyre zyrtare në rrjetet sociale për qëllime partiake apo elektorale. Pasqyrimi i veprimtarive partiake dhe lektorale lejohet vetëm në llogarinë personale në këto rrjete”. Pra, presupozohet një Kryetar Bashkie X do të duhet të ketë një faqe zyrtare me emrin dhe mbiemrin konkret pa pasur asnjë lloj funksioni. Pra, do të duhet që ajo faqja zyrtare të jetë e atij personi pas asnjë lloj funksioni ....

**Znj. H. Vukaj:** Po ai funksionin nuk e lidh me emrin, dhe ai impaktin e jep për shkak të emrit. E dinë të gjithë për shëmbull që në qytetin X është kryetar bashkie Y. Atëhere si ta bësh ti zyrtare si ta bësh ti privat, ti je filani brenda mandatit, pra ti ke të njëjtin impakt. Kështu që kjo është ajo që tha kolegu..

**Znj. P. Doçaj:** Propozimi i Komisionerit ka të bëjë pikërisht me këtë, që në faqen zyrtare ku ai ka fotografitë e martesës, së gruas, të fëmijëve, do mund të hedhi aty edhe atë aktivitetin që ka si individ ama si funksionar nuk do të duhet të hedhi asnjë veprimtari ky është koncepti.

**Znj. H. Vukaj:** Nuk është zgjidhje ....

*Zbardhi materialin audio*

*Ardita ÇAMI*





*Z. M. Çakaj:* Jam shumë dakord me këtë propozim. Jam i qartë për këtë propozim por problemi është e keni menduar pak se çfarë mund të ndodhi. Të gjithë këta zyrtarët, unë personalisht po të isha në këtë situatë nëse do të vendosej ndalimi në faqet zyrtare do ta bëja në faqen personale mund ta jap edhe në dy, tre, katër, po në faqen personale me emër me mbiemër personale vendos edhe një foto timen, të familjes dhe zhvilloj të gjithë aktivitetin promovues e zhvendos aty. Pra, në thelb e arrijmë ne qëllimin?

*Znj. P. Doçaj:* Në frymë të...

*Znj. I. Nano:* Më fal, ndjesë që po hyj në këtë diskutim. Pra, bëhet fjalë vetëm për pasqyrimin e veprimtarive partiake dhe elektorale në...

*Z. M. Çakaj:* Po pra, po, po.

*Znj. I. Nano:*.. apo në llogaritë personale, pra jo në veprimtaritë publike. Veprimtaritë publike janë në faqen e instuticionit. Elektorale dhe partiake në faqen personale. Kjo është ideja.

*Z. M. Çakaj:* Kryetari i bashkisë nuk e bën atje, ose një drejtor i zakonshëm...

*Znj. I. Nano:* Kryetari i bashkisë është një individ në fund fare...

*Z. M. Çakaj:* Po, pikërisht pra...

*Znj. I. Nano:* Është qytetar...

**Znj. P. Doçaj:** Detyrën funksionale, ai e hedh te faqja zyrtare si kryetar, ama veprimtarinë e tij personale, që mund të jetë edhe ajo politike ai do ta pasqyrojë te faqja personale e tij. Në frymë të kësaj ëhstë sjellë.

**Z. M. Çakaj:** Po ekzaktësisht, por e di çfarë do të ndodhë? Ato veprimtari të ndaluara që do të reklamoheshin në faqen zyrtare, do të reklamohen në faqen individuale. Çfarë arritëm ne me këtë?

**Znj. P. Doçaj:** Propozimi është pikërisht që individi të jetë i lirë të publikojë çfarë të dojë në faqen e tij personale, por jo si funksionar publik.

**Z. M. Çakaj:** Po, po qartë, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Dakord! E votuam kundër besoj Kreun II!  
Kreun III, ju ftoj ta votojmë, besoj kundër?! S'ka njeri dakord se s'ka çfarë hyn në fuqi dhe çfarë të shfuqizohet!

**Kush është dakord?**

**Pro:** S'ka!

**Kundër:** 5 (z. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Nuk miratohet!**

Nuk miratohet Kreu III.

Atëherë dhe njëherë në tërësi, për procedurë!

**Kush është dakord?**

**Pro:** S'ka!

**Kundër:** 5 (z. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, z. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

**Nuk miratohet!**

Çështje jashtë rendit të ditës nuk kemi, mbledhjen e deklaroj të mbyllur!

**Vendimi nr. 9**